

Përfshirja e Qasjes së Bazuar në të Drejtat e Njeriut në Kornizën Rregullative të Kosovës për Arsimin e Lartë dhe zbatimi i saj në Institucionet e Arsimit të Lartë





nga Xhavit Rexhaj

Rishikuar nga Louise Sperl

Përmbajtja

I) Hyrje	6
Historiku	7
Metodologjia	9
II) Teoria dhe konceptet kyçe	10
III) Prezantimi dhe diskutimi i rezultateve	10
Kushtetuta e Republikës së Kosovës.....	12
Analizë kritike e Kushtetutës	14
Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037)	14
Analizë kritike e Ligjit për Arsimin e Lartë.....	17
Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021.....	18
Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shqipëri Kosovare 2017-2021	20
Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.....	20
Analizë kritike e qasjes drejt planeve strategjike.....	21
Aktet nënligjore të MASHT.....	21
Manuali i Akreditimit i Agjencisë Kosovare për Akreditim.....	24
Analizë kritike e akteve nënligjore	25
Statutet e Universiteteve	25
Analizë kritike e Statuteve të Universiteteve.....	27
IV. Zbatimi i QBDNJ në universitetet publike	26
Zbatimi i parimeve të QBDNJ në planifikimin e dokumenteve, rregullave dhe procedurave.....	28
Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës.....	28
Plani Strategjik i Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren.....	29
Plani Strategjik 2017-2022 i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan	29
Plan Strategjik 2015 - 2020 i Universitetit të Gjakovës :.....	31
Plani Strategjik 2018-2021 i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”	32
Analizë kritike e zbatimit të QBDNJ-së në planet strategjike dhe në rregullore	32
Intervistat me personelin e universitetit: Prezantimi i gjetjeve.....	32
V. Konkluzionet dhe rekomandimet	38
Konkluzionet.....	38
Rekomandimet.....	39
Referencat	42
Aneksi 1: Lista e dokumenteve të rishikuara.....	44
Aneksi 2: Ekstrakt i nxjerrë nga Manuali i Akreditimit që përmban dispozitat përkatëse të QBDNJ (standartet dhe treguesit).....	45
Aneksi 3: Anketa me stafin dhe menaxhmentin e universiteteve publike.....	48

Përmbledhje ekzekutive

Ky studim është zhvilluar në kuadër të kornizës së projektit HERAS, projekt i Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA) që mbështetë Kosovën në fushën e arsimit të lartë dhe të hulumtimit. Studimi synon t'i familjarizojë palët e interesuara arsimore me politikën dhe rregulloret përkatëse në fushën e arsimit të lartë në Kosovë nga perspektiva e të drejtave të njeriut. Studimi ka analizuar dimensionet e të drejtave të njeriut dhe parimet e pandara të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut kundrejt politikave dhe kornizës ligjore të arsimit të lartë në Kosovë dhe zbatimit të tij në institucionet e arsimit të lartë. Për këtë qëllim, është analizuar korniza ligjore përkatëse, duke filluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet themelore që rregullojnë arsimin, udhëzimet administrative që rregullojnë operimet dhe akreditimet e institucioneve të arsimit të lartë të Kosovës, programet dhe statutet e universiteteve. Në të njëjtën kohë, janë analizuar planet strategjike të gjashtë universiteteve publike dhe është zhvilluar një sondazh me menaxhmentin dhe personelin e universiteteve publike në mënyrë që të vlerësohet nga perspektiva e të drejtave të njeriut shkalla e zbatimit të dispozitave ligjore në universitete.

Sa i përket kornizës ligjore, dokumentet ligjore mund të ndahen në dy grupe - varësisht nga mënyra se si pasqyrohen dhe përfshihen dimensionet e të drejtave të njeriut dhe parimet: Së pari, ekzistojnë dokumente ligjore të cilat parashohin *veprime pozitive me qëllimin përfundimtar të arritjes së barazisë*. Kjo përfshinë Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe Manualin e Akreditimit të Agjencisë Kosovare për Akreditim. Këto dy dokumente parashohin mundësinë e veprimit pozitiv në mënyrë që të sigurohet barazia e bazuar në nevojat e individëve apo grupeve të caktuara të cenueshme. Së dyti, ekzistojnë dokumente ligjore të cilat nuk parashohin në mënyrë eksplicite veprimet pozitive, por në vend të kësaj përfshijnë dhe i referohen parimeve dhe dimensioneve të caktuara të të drejtave të njeriut, përfshirë Ligjin për Arsimin e Lartë (2011) dhe udhëzimet administrative të MASHT-it të cilat rregullojnë arsimin e lartë. Këto dokumente synojnë sigurimin e barazisë për të gjithë por ndjekin qasjen “masë e njëjtë për të gjithë”. Ky grup i dokumenteve zbaton qasjen tematike ndaj të drejtave të njeriut, duke adresuar çështje dhe dimensione siç janë barazia gjinore, bursat dhe pjesëmarrja e barabartë në arsimin e lartë.

Në grupin e fundit, duket të ketë një qasje relativisht të kufizuar ku adresohen parime dhe dimensione të caktuara të të drejtave të njeriut, por mungon qasja sistematike dhe origjinale e bazuar në të drejtat e njeriut. Kjo i referohet posaçërisht adresimit të nevojave të veçanta të grupeve të cenueshme, përfshirë përmes veprimit pozitiv, në vend të qasjes “masë e njëjtë për të gjithë”.

Në përgjithësi, të drejtat e njeriut nuk janë të integruara në mënyrë sistematike në të gjitha dokumentet ligjore. Në vend të kësaj, të drejtat e njeriut - sado mirë të jenë paraqitur në disa dokumente - janë të kufizuara në praktikë në disa aspekte në vend se të sigurojnë një kornizë gjithëpërfshirëse pro -aktive dhe dinamike e cila pasqyrohet dhe aplikohet në mënyrë koherente në tërë ligjin.

Ky studim ka ardhur në përfundim se ekziston nevoja për qasje më sistematike të bazuar në të drejtat e njeriut, duke siguruar kështu edhe veprime më pozitive në arsimin e lartë sipas nevojë. Kjo qasje duhet të bazohet në frymën dhe parimet e Kushtetutës së Kosovës dhe në Manualin e lartcekur të Akreditimit. Njëkohësisht, Qendra për të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Prishtinës dhe Instituti për Hulumtimin e Sundimit të Ligjit dhe për të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Pejës do të mund të shërbenin si qendra burimore dhe pika kontakti për fuqizimin e mëtutjeshëm të hulumtimit arsimor, promovimin dhe ndërtimin e kapaciteteve në fushën e të drejtave të njeriut në universitete dhe jo vetëm.

I) Hyrje

Ideja për këtë vështrim ka ardhur nga punëtorja e HERAS për zbatimin e qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin e lartë, të mbajtur në Prill 2019. Objektivat kryesore të punëtorisë ishin si në vijim:

- Të kuptohet si HERAS synon a.) t'i integrojë të drejtat e njeriut në aspektet e ndryshme të arsimit të lartë dhe b.) të inkurajojë promovimin e Dimensionit Social të Arsimit të Lartë të Procesit të Bolonjës në Kosovë; dhe c.) ta shqyrtojë progresin e arritur deri më tani në këto fusha brenda HERAS;
- Të kuptojë sfidat kryesore në zbatimin e QBDNJ në sektorin e arsimit të lartë në Kosovë dhe të identifikojë zgjidhjet e mundshme;
- Të jetë në gjendje të identifikojë rolet e mundshme të Institucioneve të Arsimit të Lartë në promovimin e të drejtave të njeriut në shoqëri.

Përfaqësuesit e MASHT-it dhanë një prezantim të dimensioneve të të drejtave të njeriut në kornizën ligjore të sistemit të arsimit të lartë të Kosovës, duke ofruar një përshkrim dhe përmbledhje të shkurt të dokumenteve kryesore. Organizuesit konsideruan prezantimin si bazë e shkëlqyeshme për shtrirje të mëtutjeshme në mënyrë që ta krijojnë një pamje më të plotë të pranisë (ose mungesës) së qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në kornizën ligjore e cila rregullon arsimin e lartë në Kosovë. Për këtë qëllim, HERAS organizoi një studim të kornizës ligjore e cila rregullon arsimin e lartë në Kosovë. Raporti aktual paraqet gjetjet kryesore të këtij hulumtimi.

Qëllimi kryesor i këtij shqyrtimi ishte eksplorimi i dimensioneve të të drejtave të njeriut dhe aspekteve që pasqyrojnë qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut në politikat dhe kornizën ligjore të arsimit të lartë në Kosovë dhe zbatimin e tyre në institucionet e arsimit të lartë. Përveç kësaj, ky shqyrtim synoi familjarizimin e palëve të interesit me politikat dhe rregulloret përkatëse në fushën e arsimit të lartë në Kosovë nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut.

Objektivat kryesore të këtij shqyrtimi ishin:

- Analizimi i dokumenteve kyçe të kornizës ligjore që rregullon arsimin e lartë në Kosovë për ta vlerësuar shkallën e tyre të aplikimit të qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut.
- Krahasimi i qasjes së aplikuar në dokumentet e ndryshme ligjore dhe në aktet nënligjore për rregullimin e çështjeve të arsimit të lartë dhe zbatimin e mundshëm të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut si dhe Dimensionin Social të Arsimit të Lartë në përputhje me proceset e Bolonjës.
- Identifikimi i mënyrave më të mira për kompensimin e boshllëqeve në kornizën ligjore aktuale në mënyrë që të fuqizohet qasja e bazuar në të drejtat e njeriut në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës.

Në pajtim me objektivat e lartcekura, shqyrtimi ka tentuar të gjejë përgjigje në pyetjen nëse korniza ligjore që rregullon arsimin e lartë në Kosovë pasqyron vlerat dhe parimet themelore të të drejtave të njeriut dhe nëse qasja e bazuar në të drejtat e njeriut zbatohet në rregullimin e jetës akademike në institucionet në fjalë.

Historiku

Analiza aktuale nuk është studimi i parë lidhur me zbatimin e qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë:

Projekti HigherKos¹ ka zhvilluar një hulumtim² në periudhën 2014-2015 lidhur me shkallën e implementimit të parimeve të Dimensionit Social në Arsimin e Lartë në përputhje me Procesin e Bolonjës në Kosovë. Hulumtimi ka përfshirë hulumtimin e dokumenteve të politikave dhe praktikave kombëtare dhe ka zhvilluar thellësisht grupe fokusi për temat që janë pjesë e pandarë e Dimensionit Social me organet e arsimit të lartë, institucionet, personelin mësimdhënës, studentë dhe OSHC-të aktive në çështjet e arsimit të lartë dhe të komuniteteve. Hulumtimi ka gjetur përpjekje të konsiderueshme dhe disa praktika të mira të zhvilluara nga organet dhe institucionet e arsimit të lartë. Megjithatë, është gjetur se **ekziston nevoja për një qasje më sistematike dhe koherente në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës për t'i përmbushur më mirë nevojat e grupeve të nën-përfaqësuara, përfshirë përmes krijimit të një plani strategjik për ta nxitur zbatimin e Dimensionit Social të Arsimit të Lartë të sistemit të Bolonjës në Kosovë** (HigherKos, 2015).

Një hulumtim tjetër përmes përdorimit të **sondazhit online** është zhvilluar nga ekipi HERAS, duke hulumtuar aspektet e ndryshme të zbatimit të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, i cili ka adresuar personelin mësimdhënës, personelin administrativ/menaxhues si dhe studentët e universiteteve publike (mostër e vogël, Maj 2018). Sondazhi gjeti se aspektet e të drejtave të njeriut në mësimdhënie, hulumtim, menaxhim/administrim nuk adresohen në mënyrë sistematike dhe, në shumicën e rasteve, nuk bien në përgjegjësinë e departamenteve të caktuara. Shumica e të anketuarve besojnë gjithashtu se studentët e të gjitha disiplinave duhet ta kenë mundësinë për të vijuar një kurs hyrës për të drejtat e njeriut. 72,97% e të anketuarve deklaruan se ekzistojnë disa kapacitete për integrimin e të drejtave të njeriut në mësimdhënie, në kurrikulë dhe në hulumtim. 21% e të anketuarve lanë të kuptohet se mund të ekzistojë një kornizë ligjore e cila siguron të drejtat e njeriut, por personalisht nuk ishin në dijeni për këtë. Lëndët që janë në dispozicion me të drejtat e njeriut si përmbajtje kryesore përfshijnë lëndë për të drejtën ndërkombëtare (Gjilan, Pejë) dhe e drejta humanitare (Gjilan).

HERAS gjithashtu ka mbështetur edhe një studim për “Përfshirja e të drejtave të njeriut në zhvillimin e kurrikulave”³ në Universitetin e Prishtinës.

Hulumtimi tregoi se të drejtat e njeriut nuk pasqyrohen në mënyrë koherente dhe sistematike në të gjitha programet e ofruara nga njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës. Siç është dëshmuar me fakte, programet studimore në fakultetet teknike dhe të shkencave natyrore nuk i adresojnë fare aspektet e të drejtave të njeriut, por në vend të kësaj e përfshijnë etikën si një komponent apo parametër siç është përkufizuar në këtë hulumtim. Ndërsa, në programet e shkencave shoqërore, në mjekësi, bujqësi dhe veterinarit dhe në edukim, çështjet e të drejtave të njeriut adresohen deri në një shkallë por gjithashtu jo në mënyrë sistematike dhe koherente.

Në kuadër të studimeve të shkencave shoqërore, të drejtat e njeriut adresohen në dy mënyra të ndryshme - ose si temë/përmbajtje kryesore ose si çështje ndërsektoriale. Për ilustrim, në Fakultetin Juridik, të drejtat e njeriut trajtohen si përmbajtje kryesore dhe përfshijnë instrumentet e të drejtave të njeriut të parapara me kornizën ligjore në Kosovë (për shembull për sigurimin e barazisë), ndërsa në programet e Fakultetit Filozofik dhe të Edukimit, aspekte të të drejtave të njeriut trajtohen, për shembull, në nivel të avokimit, parandalimit dhe ngritjes së vetëdijesimit (Loxha, 2018).

¹Një projekt në mbështetje të arsimit të lartë dhe hulumtimit në Kosovë, i përkrahur nga Agjencia Austriake për Zhvillim i cili i ka paraprirë projektit HERAS.

²<http://www.wus-austria.org/files/docs/Report%20Social%20Dimension%20Kosovo%20final%2014072015.pdf>

³Autor i studimit ishte Z. Besnik Loxha, Drejtor i Zyrës për Zhvillim Akademik në UP.

Metodologjia

Ky vështrim bazohet në hulumtim “nga tavolina” dhe në një anketë të përshtatur duke adresuar menaxhmentin dhe personelin në universitetet publike për të vlerësuar shkallën e zbatimit të qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në dokumentet ligjore të cilat rregullojnë sektorin e arsimit të lartë në Kosovë (shih Aneksin 3). Vështrimi kishte për qëllim që, në njërën anë, të identifikojë përmbajtjen që lidhet me të drejtat e njeriut në kornizën e përgjithshme ligjore e cila rregullon arsimin e lartë në Kosovë, dhe në anën tjetër, me zbatimin e qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut (d.m.th. parimet e të drejtave të njeriut) në rregullimin e çështjeve të ndryshme akademike/artistike dhe shkencore në sistemin dhe institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. Një aspekt tjetër që është trajtuar gjatë rishqyrtimit ishte drejtuar drejt natyrës së ndërhyrjeve ligjore: gjegjësisht, për të kuptuar nëse dispozitat ligjore parashohin veprimin pozitiv i cili do ta kompensonte ekzistimin e boshllëqeve në mes grupeve të ndryshme të synuara në mënyrë që përfundimisht të arrihet *barazia*, apo zgjidhjet të cilat synojnë masa të *barabarta* për të gjithë pavarësisht situatës së tyre aktuale. Për ta ilustruar këtë, Kushtetuta e Kosovës (Neni 22) parasheh “*masa pozitive që garantojnë barazi para ligjit për grupet që janë të nën-përfaqësuara apo në pozitë të pabarabartë,*” ndryshe nga disa udhëzime administrative të cilat nuk parashohin masa të tilla pozitive për grupe të caktuara të targetit bazuar në situatën dhe nevojat e tyre aktuale (siç është rasti me Udhëzimin Administrativ për ndihmë studentëve (UA 14/2017).

Për qëllime të rishqyrtimit të **kornizës ligjore**, janë shqyrtuar dokumentet në vijim:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji për Arsimin e Lartë dhe Ligji për Promovimin e të Drejtave të Pjesëtarëve të Komuniteteve në Kosovë
- Njëzet e një Udhëzime Administrative të MASHT-it të cilat rregullojnë nën-sektorin e arsimit të lartë
- Manuali i Akreditimit i Agjencisë Kosovare për Akreditim
- Tri strategji në fushën e arsimit, komuniteteve dhe riatdhesimin e të kthyerve
- Statutet e universiteteve dhe rregulloret individuale të gjashtë universiteteve publike.

Shqyrtimi është përcjellë me një vlerësim të **zbatimit të dispozitave ligjore** që udhëzojnë institucionet e arsimit të lartë. Për këtë qëllim, planet e zhvillimit strategjik të gjashtë universiteteve publike janë këqyruar për të parë praninë e qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në masat dhe aktivitetet strategjike; janë rregulloret dhe procedurat e gjashtë universiteteve për ta vlerësuar shkallën e tyre të zbatimit të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut.

Në fund, janë zhvilluar intervista me anëtarët e menaxhmentit dhe personelit mësimdhënës (duke u fokusuar në ata që janë më aktiv në fushën e të drejtave të njeriut) në këto universitete me qëllim të gjetjes së pranisë apo mungesës së praktikave dhe shembujve që ilustrojnë zbatimin e qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në këto universitete. Është hartuar një anketë për këtë qëllim (bazuar në sondazhin online fillestar të bërë nga HERAS në vitin 2017) duke iu referuar aspekteve të të drejtave njerëzore në zhvillimin e kurrikulës, praktikave të mësimdhënies, hulumtimit dhe organizimit institucional të universiteteve. Anketa i është shpërndarë tre personave në çdo universitet publik: një prorektorit, një anëtarit të personelit dhe një koordinatorit të zyrës për sigurimin e cilësisë në çdo universitet. Trembëdhjetë të anketuar i dërguan përgjigjet e tyre në zyrën e HERAS. Me tre nga këta të anketuar janë zhvilluar intervista përcjellëse për të marrë informata shtesë lidhur me aspektet në fjalë.

II) Teoria dhe konceptet kyçe

“Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut ka të bëjë me **fuqizimin e njerëzve për të ditur dhe kërkuar të drejtat e tyre** dhe me rritjen e **aftësisë dhe llogaridhënies së individëve dhe institucioneve përgjegjës për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave**”. Në bazë të udhëzimeve të Komitetit Finlandez të UNICEF-it për OJQ-të, QBDNj “*është kornizë konceptuale për procesin e zhvillimit të njeriut që sipas normave bazohet në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe nga pikëpamja operationale e drejtuar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.*” (Unicef Finland, 2015)

Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut bazohet në parimet në vijim (akronimi **PANEL**⁴):

- **Participation** - Pjesëmarrja
- **Accountability** - Llogaridhënia
- **Non-discrimination and equality** – Mos-diskriminimi dhe barazia
- **Empowerment** - Fuqizimi, dhe
- **Legality** - Ligjshmëria

Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut

- Thekson **proceset dhe rezultatet**
- Tërheqë vëmendjen tek **grupet e marginalizuara**
- Punon drejt **ofrimit të shërbimit të barabartë**
- Zgjeron dhe **thellon pjesëmarrjen**
- **Siguron pronësi vendore** të proceseve të zhvillimit
- **Forcon llogaridhënien** e të gjithë faktorëve

Sipas UNESCO/UNICEF, “*E drejta në arsim ka një kohë që është pranuar se përfshinë jo vetëm qasjen në ofrimin e arsimit, por edhe obligimin për ta eliminuar diskriminimin në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, për të vendosur standardet minimale dhe për ta përmirësuar cilësinë.*” (UNICEF, 2007) Autorët e dokumentit theksojnë gjithashtu rëndësinë e arsimit në përmbushjen e çfarëdo të drejte qytetare, politike, ekonomike apo sociale.

I lidhur ngushtë me termin më global të qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut është koncepti i Dimensionit Social të Arsimit të Lartë të Procesit të Bolonjës. Kuptimi aktual i Dimensionit Social të Procesit të Bolonjës është formuluar në vitin 2007 në Komunikatën e Londrës të Ministrave⁵ (EHEA, 2007):

“Ne ndajmë aspiratat shoqërore të cilat trupi studentor që futet, merr pjesë në dhe përfundon arsimin e lartë në të gjitha nivelet duhet ta pasqyrojë llojllojshmërinë e popullatave tona. Ripohojmë rëndësinë që studentët të jenë në gjendje t’i përfundojnë studimet e tyre pa pasur pengesa që lidhen me të kaluarën e tyre sociale apo ekonomike. Prandaj, vazhdojmë përpjekjet tona për të ofruar shërbime adekuate për studentët, të krijojmë rrugë më fleksibile të nxënies në dhe brenda arsimit të lartë, dhe për ta zgjeruar pjesëmarrjen në të gjitha nivelet në bazë të mundësive të barabarta.”

⁴Për informata shtesë lidhur me qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut dhe parimet e saj, shihni për shembull <http://www.ennhri.org/Applying-a-Human-Rights-Based-Approach>

⁵ Ministrat e vendeve evropiane përgjegjëse për arsimin e lartë ishin në takim të rregullt ministror në Londër si pjesë e Procesit të Bolonjës.

Korniza e të drejtave të njeriut në Kosovë:

Të drejtat që gjenden në DUDNJ dhe instrumentet tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtën në arsim, janë bërë drejtpërsëdrejti të zbat ueshme në Kosovë përmes Nenit 22 të Kushtetutës. Këto janë KEDNJ dhe Protokollat e saj, PNDCP, Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, KNEDR, KEDKG, KDF dhe KKT e OKB. Ky nen lidhet me Nenit 47 (e drejta për arsim) dhe Nenin 59 (të drejtat e komuniteteve në arsim), të cilat shtrojnë themelin për zbatimin e plotë të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin në Kosovë në përgjithësi, dhe në arsimin e lartë, në veçanti. Dispozitat e Kushtetutës së Kosovës shkojnë përtej pranisë së thjeshtë dhe zbatimit të të drejtave të njeriut në sistemin e arsimit në Kosovë, pasi që ato parashohin: *mundësi të barabarta në arsim për çdonjërin në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike* (2008, p. Art. 47). Fryma e njëjtë gjendet edhe në dispozitat që rregullojnë lirinë akademike, hulumtimin shkencor dhe punën artistike (Neni 48) dhe Neni 59 për të drejtat e komuniteteve në arsim. Kjo qasje e garantimit të mundësive të barabarta dhe masave pozitive / veprimeve afirmative të bazuara në nevojat individuale në vend të masave kolektive të konfirmuara në Nenin 24 [Barazia para ligjit], e cila parasheh mundësitë e masave pozitive të cilat garantojnë barazi para ligjit për grupet që janë të nën-përfaqësuara apo në pozitë jo të barabartë: *“Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”* (2008, p. Art. 24)

Kjo qasje e Kushtetutës së Kosovës ka shtruar themelet për zbatimin e plotë të frymës dhe të dispozitave konkrete të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në nivele dhe segmente të caktuara të arsimit në Kosovë. Ky raport synon të tregojë shkallën në të cilën korniza ligjore e Kosovës në arsimin e lartë e ka përmbushur këtë kërkesë ambicioze të përcaktuar në Kushtetutën e Kosovës. Pjesa e metodologjisë e cekur më sipër tregon politikat/dokumentet e rishqyrtuara në proces të këtij hulumtimi të cilat përbëjnë bazën ligjore të sektorit të arsimit të lartë dhe të institucioneve në Kosovë.

III) Prezantimi dhe diskutimi i rezultateve

Kjo pjesë përmbledhë rezultatet e rishqyrtimit të kornizës ligjore të Kosovës në fushën e arsimit të lartë. Ajo përqendrohet në analizën e të drejtave të njeriut lidhur me dispozitat ligjore dhe parimet në dokumentet kyçe të cilat rregullojnë sistemin dhe institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. Për këtë qëllim, janë shqyrtuar dokumentet kryesore juridike dhe disa dokumente strategjike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës⁶

Siç është theksuar në pjesën e teorisë të këtij rishqyrtimi, kapitujt e tërë (2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Kushtetuta më tej në këtë dokument) i dedikohen të drejtave dhe lirive themelore. Aplikimi i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare (Neni 22) merr vend të rëndësishëm në mesin e neneve të Kushtetutës së Kosovës, së bashku me të drejtën në arsim (Neni 47) dhe të drejtat e komuniteteve në fushën e arsimit (Neni 59, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 14).

Dispozitat kushtetuese më të rëndësishme që garantojnë barazinë dhe të drejtat në fushën e arsimit janë paraqitur në vijim.

Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] parasheh disa instrumente ndërkombëtare, përfshirë instrumentet në vijim të aplikueshme dhe relevante për sektorin e arsimit siç janë (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; ... (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; ... (6) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; dhe (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës.

Nëse shikohen dispozitat e një prej këtyre instrumenteve, respektivisht Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (The Council of Europe, 1950), mund të shihet se Kushtetuta e Kosovës zbaton qasje shumë të avancuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në arsim. Përderisa Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut i referohet⁷ të drejtës në arsim në **përgjithësi** dhe **për të gjithë personat** dhe të drejtës së prindit për t'i siguruar arsim fëmijëve të tij, Kushtetuta e Kosovës i referohet **aftësive dhe nevojave individuale** dhe **lirisë akademike dhe të drejtës për punë shkencore / artistike**.

Fryma e njëjtë e Kushtetutës së Kosovës pasqyrohet edhe në dimensionet tjera. Për shembull, Neni 24 [Barazia ligjore] në par. 3 parasheh **masat pozitive** që garantojnë **barazi ligjore** për **grupet që janë të nën-përfaqësuar apo në pozita të pabarabarta**:

"3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato (2008, p. Art. 24)." Ndonëse jo drejtpërsëdrejti e lidhur me arsimin, kjo dispozitë shton veprimin pozitiv në një fushë të rëndësishme të jetës së qytetarëve në Kosovë, por gjithashtu siguron barazi në trajtimin e të gjitha çështjeve (përfshirë arsimin) në gjykatat e Kosovës.

⁶ <http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

⁷ "Asnjë personi nuk do t'i mohohet e drejta në arsim. Në ushtrimin e çfarëdo funksioni të cilin e fillon në lidhje me arsimin dhe mësimdhënien, Shteti do ta respektojë të drejtën e prindërve për të garantuar arsim dhe mësimdhënie të tillë në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike."

Ekzistojnë disa artikuj tjerë në Kushtetutë të cilët rregullojnë në mënyrë direkte apo indirekte të drejtat e njeriut dhe qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin e lartë në Kosovë: Neni 47 [E drejta në arsim] përcakton se: *1. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike. 2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.* (2008, p. Art. 47).” Kjo dispozitë e përgjithshme dhe fryma e saj shtrihen më tej për të përfshirë arsimin e lartë dhe hulumtimin shkencor / punën artistike, në nenin vijues Neni 48 [Liria e Artit dhe e Shkencës] duke përcaktuar se: *“1. Liria e krijimit artistik dhe shkencor është e garantuar. 2. Liria akademike është e garantuar* (2008, p. Art. 47).”

Segment i rëndësishëm i së drejtës për shkollim, gjegjësisht të drejtat e komuniteteve, janë adresuar në mënyrë të veçantë në Nenin 59 [Të Drejtat e Komunitetëve dhe Anëtarëve të Tyre], duke i dhënë vend të rëndësishëm shkollimit në mesin e të drejtave të komuniteteve në shoqërinë kosovare.

Ky nen përcakton se “Anëtarët e komuniteteve kanë të drejtë, që në mënyrë individuale apo si komunitet:

- (1) shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre;
- (2) të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet në njërin nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës sipas zgjedhjes së tyre;
- (3) të marrin arsimim publik para-fillor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre deri në masën e përcaktuar me ligj, ku pragu për themelimin e paraleleve apo shkollave të veçanta për këtë qëllim do të jetë më i ulët sesa ai që përcaktohet rëndom për institucionet arsimore;
- (4) të themelojnë dhe të menaxhojnë institucionet private të arsimit dhe të trajnimit për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
- (5) të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre lirisht në jetën private dhe publike;
- (14) të themelojnë shoqata të artit, kulturës, shkencës dhe arsimit si dhe shoqata të studiuesve dhe shoqata tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre.” Paragrafë t 2 dhe 4 më sipër i referohen qartë nevojës për institucione publike për të siguruar arsimim të lartë për komunitetet në të gjitha nivelet (Par. 2) dhe mundësinë për institucionet private të komunitetit për arsim dhe trajnim të mbështetën nga fondet publike (Par. 4).

Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe të Anëtarëve të Tyre në Kosovë⁸ promovon qasjen e njëjtë sikurse Kushtetuta e Kosovës, ndonëse e kufizuar në fushën e të drejtave të komuniteteve etnike (03/L-047a). Në Nenin 8.11 të tij, Ligji parasheh masa të veçanta që shërbejnë për të plotësuar nevojat e veçanta të komuniteteve etnike në arsimin e lartë duke përcaktuar që: “Qeveria e Kosovës siguron qasje të barabartë të personave që iu përkasin komuniteteve në arsimin e lartë në nivelin universitar. Në këtë drejtim, Qeveria krijon masa të veçanta për të siguruar pranimin e kandidatëve që vijnë nga shkollat e komuniteteve në institucionet e arsimit të lartë dhe universitar” (Government of the Republic of Kosovo, 2008).

Analizë kritike e Kushtetutës

Kjo qasje e Kushtetutës vendos standard të lartë në fushën e të drejtave të komuniteteve në përgjithësi, dhe në arsimimin e anëtarëve të komuniteteve etnike, në veçanti. Secili ligj apo akt nënligjor që rregullon fushën e arsimit, sipas Kushtetutës, duhet të garantojë një qasje afirmative dhe masa pozitive të cilat mundësojnë barazi në adresimin e çështjeve të cilitdo grup të synuar në sektorin e arsimit. Kjo vlen jo vetëm për shkollimin e detyrueshëm, por gjithashtu edhe për fushat e arsimit të lartë, të punës shkencore dhe artistike duke iu kushtuar atyre paragraf të veçantë. Në anën tjetër, shkollimit të komuniteteve etnike, përfshirë arsimin e lartë, i është dhënë rëndësi e duhur duke siguruar një varg dispozitash pozitive në mbështetje të arsimit të tyre. Pjesa në vijim do të tregojë nëse përcaktimet Kushtetuese janë përkthyer në mënyrë adekuate në dispozitat ligjore dhe në aktet nënligjore për të siguruar qasje të sigurt të bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin e lartë në Kosovë.

⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2531&langid=2>

Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës⁹(Nr. 04/L-037)

Ligji për Arsimin e Lartë (LAL) i kushton vëmendje të duhur të drejtave të njeriut në disa nga nenet e tij. Në pjesën hyrëse të Ligjit, të drejtat e njeriut janë të pranishme (si përmbajtje) në pjesën për Parimet (Neni 2), Objektivat dhe Organizimi i arsimit të lartë (Neni 4), dhe në Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Ministrisë (Neni 6).

Për shembull, në Nenin 2 të këtij Ligji (MEST, 2011) lidhur me parimet, shumica e dispozitave kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut (shikuar në radhë të parë nga dimensiononi i *barazisë*):

*“1. Ofrimi i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës bazohet në parimet si në vijim:
1.1 lirinë akademike, të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe interpretimi i saj i mëtutjeshëm nga ana e gjyqësorit;
1.2 barazia para ligjit për të gjithë bartësit e arsimit të lartë;
1.3 mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim. 1.4 shumëllojshmëria dhe cilësia në programe të studimit dhe në mbështetje të mësim-nxënies.”*

Neni (4) për Objektivat dhe organizimin e Arsimit të Lartë, paraqet qartë interpretimin e dispozitës kushtetuese për të drejtën në arsimin e lartë në këtë Ligj:

“1. Objektivat e arsimit të lartë janë: ...1.3. ofrimi i mundësive për të gjithë banorët e Kosovës që janë të aftë për të përfituar nga ky arsimim dhe për t’i kontribuar shoqërisë dhe vendit të tyre gjatë gjithë jetës së tyre.”

Formulimi i këtij paragrafi është pjesërisht në pajtim me interpretimin e së drejtës në arsimim në Kushtetutën e Kosovës, meqenëse ai fillon nga interesat dhe aftësitë e përfituesve.

Neni 6 i Ligjit për Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Ministrisë në ofrimin e Arsimit të Lartë, trajton të drejtat e komuniteteve lidhur me arsimimin si çështje ndër-sektoriale në mesin e të gjitha kompetencave dhe përgjegjësi të MASHT-it, duke theksuar se *“2. Gjatë ushtrimit të kompetencave dhe detyrave sipas këtij Ligji, Ministria respekton dhe promovon të drejtat e Komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve¹⁰ dhe të Anëtarëve të Tyre në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-047, Mars 2008)¹¹”*

⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2761>

Ky ligj (për Komunitetet) në Nenin e tij 1.2 thotë se: “Republika e Kosovës ndërmerr masa të veçanta për të siguruar barazi të plotë dhe efektive të komuniteteve dhe të anëtarëve të tyre, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre të veçanta. Këto masa nuk konsiderohen si akt diskriminimi (The Assembly of the Republic of Kosovo, 2008).” Formulimi dhe fryma e tij, në këtë dhe në nenet tjera, është shumë më tepër në pajtim me qasjen afirmative të Kushtetutës së Kosovës, pastaj siç do ta shohim në vijim, formulimet e Ligjit për Arsimin e Lartë. Analizat kanë treguar se formulimi i Ligjit për Arsimin e Lartë synon ofrimin e *barazisë për të gjithë anëtarët* e komunitetit akademik në Kosovë, por bazuar në nevojat e tyre individuale dhe të veçanta në mënyrë që të mundësohet zhvillimi i plotë i potencialit të tyre - siç përcaktohet në Kushtetutën e Kosovës. Në vijim janë disa ilustrime të qasjes paksa më të kufizuar të Ligjit për Arsimin e Lartë të cilat ofrojnë integrimin e parimeve të caktuara të të drejtave të njeriut, por nuk zhvillojnë më tej *qasjen* sistematike të bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin e lartë.

Dispozitat që rregullojnë pranimin e studentëve, tarifat e studentëve dhe të drejtat dhe obligimet e studentëve nuk përfshijnë në mënyrë të sinqertë dimensionin e të drejtave të njeriut apo Dimensionin Social të Procesit të Bolonjës. Gjatë adresimit të aspekteve përkatëse (financimi, tarifat, të drejtat dhe obligimet, etj.), këto dispozita zbatohen më tepër qasje akademike dhe teknike duke anashkaluar qasjen koherente të bazuar në të drejtat e njeriut apo dimensionin social.

Për ilustrim, në tërë Nenin 29, për Pranimin e studentëve, nuk ka referenca të qarta për çështjet e rëndësishme siç janë të drejtat e njeriut, barazia, përfshirja, pjesëmarrja, përfaqësimi, nevojat e veçanta dhe kështu me radhë:

“1. Secili kandidat që kalon testin e maturës, ka të drejtë të vazhdojë studimet në institucione të arsimit të lartë sipas legjislacionit në fuqi.

2. Nëpërmjet një udhëzimi administrativ, Ministria harton dispozita kur është e nevojshme dhe e dobishme, lidhur me kohën dhe organizimin e provimeve të pranimit të caktuara nga institucionet e arsimit të lartë për të lehtësuar regjistrimin në arsimin e lartë të studentëve të cilët nuk kanë hyrë në testin e maturës ose nuk e kanë kaluar atë.

3. Për fusha të veçanta studimi, bartësit publikë të arsimit të lartë mund të parashohin për disa lëndë teste shtesë për pranimin e studentëve, të cilat duhet të aprovohen nga Ministria. Kërkesat për pranim përshkruhen në mënyrë të hollësishme në rregulloret e hartuara mbi bazën e statutit të institucionit.

4. Studentët pranohen në studime Master mbi bazën e konkurrencës, sipas rezultateve të studimeve paraprake, ekuivalencës së tyre, siç përcaktohet me këtë ligj.

5. Kur numri i kandidatëve të suksesshëm e kalon numrin e vendeve të financuara nga fonde publike në dispozicion të një programi, bartësi mund të pranojë, gjithnjë mbi bazën e meritave, studentë që paguajnë tarifa në ato vende që të cilat nuk financohen me fonde publike, por deri në numrin e përcaktuar në licencën e bartësit.

6. Rregullat e përcaktuara nga bartësi publik i arsimit të lartë mund të përcaktojnë rrethanat në bazë të të cilave studentët që paguajnë shkollimin dhe të cilët arrijnë rezultate të shkëlqyeshme në mësim, mund t’u ndahet një vend studimi që financohet me fonde publike në vitin e dytë apo në vitin vijues të studimeve.

7. Bartësit privat të arsimit të lartë mund të pranojnë çdo kandidat në programet e tyre, me kusht që të mund t’i arsyetojnë veprimet e tyre para AKA-s.”

¹⁰ 1.4 Për qëllime të këtij ligji, komunitetet janë përkufizuar si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo grupe fetare që tradicionalisht janë të pranishme në Republikën e Kosovës e që nuk janë në shumicë.

<http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2531>

¹¹ http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L047_en.pdf

Ngjashëm, Neni 30 për Pagesa e shkollimit dhe Tarifat Tjera që paguhen nga studentët vendas apo të huaj ofron një qasje krejtësisht teknike me të cilën adreson një çështje që ndryshe është mjaft e ndjeshme pa marrë në konsideratë parimet e të drejtave të njeriut:

“1. Ministria përcakton në një udhëzim administrativ, i cili rishqyrtohet çdo vit, pagesën maksimale të shkollimit që duhet paguar nga studentët që pranohen në bartësit publik të arsimit të lartë, të financuar nga Ministria.

2. Pagesat për shkollim të cekura në paragrafin 1. të këtij Neni mund të përcaktohen në nivele të ndryshme:

2.1 varësisht nga fakti nëse studenti banon në Kosovë apo diku tjetër;

2.2 për programet e ndryshme sipas kostove që kanë. ...”

Neni 31, për Të Drejtat dhe Obligimet e Studentit, nuk ofron ndonjë përjashtim në këtë drejtim:

1. Studentët që janë pranuar dhe regjistruar te bartësi i arsimit të lartë hyjnë në marrëdhënie ligjore me atë bartës.

2. Studentët kanë të drejtat e mëposhtme që mund të specifikohen më tej në statutin e bartësit:

2.1 të ndjekin të gjitha ligjëratat, seminarët dhe të gjitha aktivitetet tjera arsimore të organizuara në lëndët e tyre, sipas nivelit të tyre si dhe të vijojnë, nëse ka vend, proceset e tjera të organizuara të mësimdhënies;

2.2 të shfrytëzojnë ambientet në biblioteka dhe shërbime të tjera për studentët në godinën e bartësit; dhe

2.3 të marrin pjesë në zgjedhjet për postet e studentëve në organizmat e ngritura mbi bazën e statutit të bartësit.

Shembujt e mësipërm dëshmojnë se të drejtat e njeriut të përfshira në nenet hyrëse të Ligjit nuk janë të integruara në frymën dhe pamjen e neneve që rregullojnë aspekte të ndryshme të arsimit të lartë në Kosovë (siç janë financimi, çështjet studentore, mbështetja financiare e studentëve, promovimi i personelit e kështu me radhë). Prandaj, të drejtat e njeriut pasqyrohen vetëm në mënyrë indirekte në përmbajtjen e këtij Ligji, në vend se të shërbejnë si kornizë gjithëpërfshirëse e përfshirë dhe e integruar në çdo dispozitë.

Madje edhe dispozita (Neni 32) Mbështetja Financiare për Studentin, i referohet masave që ofrojnë qasje të barabartë në arsimin e lartë, por nuk ofron masa të barabarta për qasje dhe për performancë/diplomim të suksesshëm për secilin student që ka nevojë për mbështetje në bazë të gjendjes së tij/saj të veçantë:

1. Ministria mund të nxjerrë akt nënligjor për krijimin e skemës apo skemave për mbështetje financiare të studentëve, bazuar në nevojat ekonomike.

2. Skemat të tilla për mbështetje financiare për studentët mund të përfshijnë dispozitën për të ndihmuar studentët në pagesat për shkollim dhe në pagesa tjera tek bartësi publik dhe, sipas vlerësimit të Ministrisë, tek bartësit privat të arsimit të lartë.

3. Bartësit publik të arsimit të lartë mund të krijojnë skema për mbështetje financiare të studentëve, me fonde që nuk ndahen nga burime publike.

4. Ministria ndërmerr veprime që mendon se janë të dobishme dhe të nevojshme për të siguruar se studentët e regjistruar në cilindo institucion të kenë mundësi dhe qasje të barabartë për të aplikuar në skemën apo skemat ekzistuese të mbështetjes financiare për studentët, që janë në pajtim me këtë nen.

5. Të gjitha organizatat e financuara me fonde publike, që u sigurojnë studentëve strehim, ushqim, ndihmë mjekësore dhe sociale, janë pjesë përbërëse e bartësit dhe u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji. Ministria mund të udhëzojë këto organizata lidhur me detyrimet, vetëqeverisjen dhe tarifat.

Ekzistojnë gjithashtu përjashtime të kësaj rregulle të përgjithshme, në atë se nganjëherë Ligji garanton të drejta të caktuara të njeriut. Kjo lloj qasjeje më shumë pro-aktive është i pranishëm në dispozitat që rregullojnë statutet e institucioneve të arsimit të lartë. Neni 31.4, për shembull, përcakton se *“Statuti, ose dokumenti i barasvlershëm me të, i çdo bartësi të arsimit të lartë përmban dispozita, të cilat:*

4.1 garantojnë lirinë e studentëve, brenda ligjit, për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të studentit apo të privilegjeve që mund t'i gëzojnë nga bartësi;

4.2 u garantojnë studentëve ‘lirinë e fjalës’, të organizimit e të tubimit sipas dispozitave ligjore.

4.3 mbrojnë studentët nga çdo lloj i diskriminimit;

4.4 sigurojnë mekanizma të paanshëm e objektiv për trajtimin e çështjeve disiplinore që kanë të bëjnë me studentët.”

Kjo dispozitë garanton pjesëmarrjen, përfaqësimin e barabartë, lirinë e fjalës dhe të drejtën në ankesë, ndonëse ofrohet si zgjidhje ‘një masë për të gjithë’ dhe nuk ofron masa afirmative.

Qasja e kufizuar me ofrimin e barazisë ‘një masë për të gjithë’ reflektohet gjithashtu në Nenin 17. 5. që përcakton dispozitat statutare lidhur me rolin e bordeve qeverisëse. Ky nen përcakton që statutet e tyre duhet të ofrojnë mundësi të barabartë për punësim, studime të mëtutjeshme dhe hulumtim shkencor (Par. 5.1), dhe se i tërë personeli [menaxhues] dhe organet duhet të veprojnë në përputhje të plotë me standardet më të larta të modestisë, integritetit, të sinqeritetit, të objektivitetit, të llogaridhënies, të transparencës dhe të udhëheqjes (5.2).

Dispozitat tjera të këtij ligji ofrojnë mundësi të barabarta në mënyrë të kufizuar, siç është rasti me Nenin 22.3 për financimin e arsimit të lartë në raste të *“caktimi i vendeve shtesë të studimeve brenda kufijve të licencës”*, me kusht që, nuk ka:

“3.1 efekt negativ në cilësinë e arsimit me fonde publike

3.2 nuk paragjykon detyrën e bartësit për të ushtruar veprimtarinë e tij pa asnjë lloj diskriminimi për arsye që kanë lidhje me gjininë, racën, prirjen seksuale, aftësinë e kufizuar, gjendjen martesore, ngjyrën, gjuhën, fenë, opinionet politike apo të tjera, origjinën nacionale, etnike apo sociale, përkatësinë ndaj një komuniteti etnik, pronësinë, lindjen apo që lidhen me gjendje tjera.”

Është interesante për ta parë se në çfarë shkalle këto dispozita që rregullojnë funksionimin e brendshëm të institucioneve të arsimit të lartë respektohen dhe zbatohen në statutet e universiteteve publike ¹² (ju lutem, shihni pjesën për Statutet e Universiteteve në vijim).

Analizë kritike e Ligjit për Arsimin e Lartë

Ligji për Arsimin e Lartë përfshinë disa dispozita që drejtpërsëdrejti i referohen aspekteve dhe parimeve të të drejtave të njeriut. Të tilla janë Nenet (2, 4, 6) in pjesën hyrëse, Neni 17-22 që rregullon financimin e arsimit të lartë dhe udhëheqjen në institucionet e arsimit të lartë, Nenet 31-34 për pjesëmarrjen e studentëve, tarifat e studentëve, mbështetja e studentëve, e kështu me radhë) dhe nenet që përcaktojnë statutet e institucioneve të arsimit të lartë.

¹²Në një hulumtim tjetër (Rexhaj, 2018) që është fokusuar në transparencën dhe llogaridhënien e Bordit Qeverisës të Universitetit të Prishtinës, është gjetur se dispozitat relativisht të avancuara të Ligjit për Arsimin e Lartë nuk zbatohen si duhet nga Universiteti. Për ilustrim, qasja në dokumente publike është e rregulluar me Statutin e Universitetit në një mënyrë që lë shumë në diskrecion të Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit. Përkatësisht, është vendosur një procedurë e menduar mirë dhe që merr kohë nëse dikush dëshiron të ketë qasje në dokument publike (për informata shtesë, shih pjesën “Analizë Kritike e Statuteve të Universiteteve”).

Kështu, të drejtat e njeriut përfaqësohen relativisht mirë në Ligjin për Arsimin e Lartë, veçanërisht kur merret në konsideratë numrin relativisht të madh të dispozitave që përcaktojnë apo që i referohen çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Megjithatë, sa i përket anës cilësore, du ket të jetë një qasje relativisht e kufizuar dhe e cila nuk arrin ta zhvillojë një qasje sistematike dhe të sinqertë të bazuar në të drejtat e njeriut. Elementi kyç që mungon është mungesa e një qasjeje që bazohet në nevojat e veçanta të individëve dhe grupeve në nevojë; një qasje që prezanton veprimin afirmativ dhe masat pozitive që kompensojnë boshllëqet e grupeve dhe individëve të caktuar, në vend të qasjes aktuale një masë për të gjithë. Një tjetër element që mungon është qasja e përgjithshme për të drejtat e njeriut apo fryma e përhapur përmes dispozitave ligjore të këtij ligji. Në vend të kësaj, të drejtat e njeriut, sado mirë të jenë paraqitur, përbëjnë aty më shumë një përmbajtje statike se sa një qasje pro -aktive, dinamike dhe të menduar të integruar në mënyrë koherente në tërë ligjin.

Vlen të ceket se Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë (2011) ka kaluar nëpër procedurë të parlamentit për t'u zëvendësuar me një ligj tjetër në pesë vitet e fundit. Draft ligji i ri për Arsimin e Lartë është rishikuar nga ekspertët e HERAS lidhur me qasjen e tij ndaj të drejtave të njeriut përmes dispozitave të tij. Ligji është rishikuar nga këndvështrimi i ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë. Rekomandohet që ligji i ri të harmonizohet me frymën dhe dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës në fushën e të drejtave të njeriut. Kjo mund gjithashtu të përfshijë dhe të hap dyert për masa pozitive duke siguruar kështu barazi për anëtarët e grupeve të nën-përfaqësuar dhe të grupeve në pozita të pabarabarta sipas rregullit të dispozitës kushtetuese (24.3).

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021

Në nivel kombëtar, PSAK -ja, si strategji kryesore kombëtare e Kosovës për arsim, si dhe korniza ligjore dhe strategjike përkatëse tashmë përfshinë çështjet e pjesëmarrjes, llogaridhënies dhe mos-diskriminimit të cilat janë gjithashtu parimet kyçe të QBDNJ. Prej shtatë fushave kyçe të ndërhyrjes, një i dedikohet krejtësisht vetëm çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, siç është pjesëmarrja dhe përfshirja.

Qysh në fillim, qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut i është dhënë vend i rëndësishëm duke qenë e përfshirë në deklaratën e vizionit: *Kosova, shoqëri me njohuri konkurruese, e bazuar në vlerat evropiane me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social.* Arsyeshmëria e ngjashme reflektohet edhe në deklaratën e misionit: *Zhvillimi i një sistemi arsimor të bazuar në cilësi, gjithë-përfshirje dhe llogaridhënie, që ofron arsimin dhe trajnim të individëve në përputhje me praktikën më të mira dhe standardet ndërkombëtare.*

Ndërhyrja është strukturuar në shtatë fusha tematike që mbulojnë të gjitha segmentet relevante të arsimit në Kosovë, përfshirë fushën e parë tematike që formon një element kyç të qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut.

1. Pjesëmarrja dhe përfshirja,
2. Menaxhimi i sistemit arsimor,
3. Sigurimi i cilësisë,
4. Zhvillimi i mësimdhënësve,
5. Mësimdhënia dhe mësim-nxënia,
6. Arsimi dhe aftësimi profesional dhe Arsimi për të Rritur,
7. Arsimi i Lartë.

PSAK-ja ka shtatë objektiva strategjike, një për secilën fushë tematike. Në vijim është një përshkrim i objektivës së parë strategjike: Pjesëmarrja dhe përfshirja, *“Rritja e pjesëmarrjes dhe ofrimi i mundësive të barabarta për zhvillim, aftësim dhe arsimim për secilin individ në arsimin para-universitar. (MEST, 2017).”*

Sado që është i dobishëm dhe në pajtim me trendet në fushën e të drejtave të njeriut, duket se të menduarit e kësaj objektivë strategjike fokusohet kryesisht në ofrimin e barazisë (kundrejt barazisë mbi bazën e n evojave të veçanta) dhe parasheh masa vetëm për nivelin para-universitar. PSAK-ja vlerësohet si qasje gjithëpërfshirëse¹³ ndaj çështjeve të arsimit duke zhvendosur paradigmen nga qasjet e kaluara të copëtuara në një qasje të gjerë sektoriale.

Siç u citua më lartë, kjo fushë tematike synon rritjen e pjesëmarrjes dhe ofrimin e mundësive të barabarta në arsimin para-universitar duke e bërë këtë ndërhyrje krejtësisht të fokusuar në nivelin para-universitar. Masat kyçe në këtë fushë tematike janë gjithashtu në harmoni me objektiven strategjike duke u fokusuar vetëm në nivelin para-universitar. Në bazë të këtyre gjetjeve, hulumtimi “nga tavolina” u fokusua më tej në fushën tematike të arsimit të lartë (Objektiva strategjike 7). Nga 47 masat brenda fushës tematike të arsimit të lartë, dy masa bien drejtpërsëdrejti në fushën e të drejtave të njeriut dhe një tjetër (qendrat për zhvillim të karrierës) në mënyrë të tërthortë përfshijnë qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut:

7.6. 8. Themelimi i Qendrave për Zhvillim të Karrierës në IAL

Qendrat për zhvillim të karrierës në IAL duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë programe për zhvillim të karrierës dhe përkrahjes për studentë.

7.9. 2. Zhvillimi i treguesve të ndjeshëm gjinor të performancës në arsimin e lartë.

...

7.9. 5. Zhvillimi i masave të posaçme pozitive dhe i programeve përgatitore për regjistrimin dhe mbajtjen e studentëve në IAL nga radhët e kategorive të cenueshme sociale dhe komunitetet e nën-përfaqësuar.

Kjo masë parasheh zhvillimin e programeve të posaçme përgatitore për regjistrimin e studentëve nga radhët e kategorive të cenueshme sociale. Për këtë qëllim, PSAK-ja planifikon kurse intensive për pjesëtarët e komunitetit për t'i përgatitur ata për provim pranues; politika e vendeve të rezervuara në universitet derisa të arrihet pjesëmarrja e barabartë; kurse intensive të gjuhës për ta përmirësuar njohurinë në gjuhën e mësimdhënies apo përmes programeve të mentorimit, ofrimin e transportit dhe konvikteve.

Kështu, qasja e bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin e lartë adresohet nga PSAK-ja vetëm përmes dy masave (7.9.2 dhe 7.9.5) dhe në mënyrë ndërlidhëse përmes Qendrave për zhvillim (masa 7.6.8). Hulumtimi i mëtutjeshëm do të shërbente për të konstatuar zbatimin e cilësdo nga këto masa pozitive për anëtarët e komuniteteve dhe për grupet e cenueshme. Kjo apo masat tjera nuk parashohin ndonjë veprim konkret që ofron barazi në arsimin e lartë, barazi gjinore për të regjistruarit e rinj dhe të diplomuarit në arsimin e lartë, pjesëmarrje dhe përfaqësim të barabartë në organet universitare dhe në proceset vendimmarrëse, mbështetje për studentët me nevoja të veçanta, mbështetje akademike për të përmirësuar performancën e studentëve, e kështu me radhë.

¹³Ideja e PSAK-së është të jetë strategji gjithëpërfshirëse për Sistemin e Arsimit në Kosovë, në pajtim me rekomandimet për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale në Arsim (PSAK; f. 37).

Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021¹⁴

Kjo Strategji (2017, p. 45) është plotësisht në harmoni me dispozitën kushtetuese të veprimit pozitiv për garantimin e barazisë për grupet e cenueshme. Masa 1.1.5 e kësaj Strategjie parasheh se “*Zhvillimi i masave të veçanta pozitive dhe i programeve përgatitore për regjistrimin dhe mbajtjen e studentëve në IAL nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali.*” Kjo nënkupton se kjo Strategji aplikon një qasje më proaktive për të siguruar jo vetëm pjesëmarrjen më të gjerë, por edhe për të përmirësuar performancën e studentëve gjatë studimeve të tyre (e dyta është gjithashtu në përputhje me Parimet e Bolonjës për Dimensionin Social). Kjo është paraparë të arrihet përmes vendeve të rezervuara për këto komunitete, me bursa shkollimi më të larta për anëtarët e këtyre komuniteteve dhe përmes programeve të mentorimit për përmirësimin e performancës së studentëve gjatë studimeve të tyre (f.42). Ndonëse e kufizuar për nga numri i masave (vetëm masa 1.1.5), kjo Strategji zbaton në arsimin e lartë qasje më proaktive të bazuar në të drejtat e njeriut.

Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali përmban edhe masa tjera të cilat në mënyrë të tërthortë shërbejnë për zbatimin e qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin e lartë për anëtarët e këtyre komuniteteve, siç është rasti me ofrimin e programeve të përsheptuara dhe për aftësimin profesional (Masa 1.1.6). Këto mund të shërbejnë për të avancuar qasjen e mëvonshme të përfituesve në shërbime të ndryshme të institucioneve të arsimit të lartë.

Kjo masë zërthehet më tej në dy aktivitete konkrete në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie. Këto aktivitete përfshijnë vendet e rezervuara për regjistrimin e studentëve në institucionet e arsimit të lartë, një program përgatitor për 100 studentë në vit për regjistrim në Arsimin e Lartë, bursa studentore për 50 studentë çdo vit, dhe mentorim për 50 studentë në vit për ta përmirësuar performancën e studentëve. Është parashikuar që kosto e masave të jetë rreth € 0.5 MN. (2017, p. 73).

Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar

Ministria e Brendshme e Republikës së Kosovës ka hartuar një Strategji për Riintegrimin (Ministry of Internal Affairs, 2013) e personave të riatdhesuar nga vendet tjera.¹⁵ Kjo Strategji i referohet arsimit të lartë në mënyrë periferike sa i përket personave të riatdhesuar: “Procesi edukativo -arsimor është i një rëndësie të posaçme në procesin e riintegrimin të personave të riatdhesuar. Në mesin e të kthyerve do të jetë një numër i madh i fëmijëve dhe të rinjve të cilët duhet të vazhdojnë shkollimin e tyre. MASHT duhet të jetë e gatshme t’i pranojë dhe sistematizojë të gjithë nxënësit e të gjitha komuniteteve në të gjitha nivelet e arsimit shkollor, në harmoni me legjislacionin në fuqi (Ministry of Internal Affairs, 2013).” Strategjia nuk parasheh ndonjë masë të posaçme për riintegrimin në arsimin e lartë, por në vend të kësaj i referohet Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali: “*Në anën tjetër, MASHT ka themeluar vendet e rezervuara për regjistrim në arsimin e lartë për anëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (për informata shtesë, ju lutem shikoni në vijim Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Rom dhe Ashkali).*”¹⁶

¹⁴ http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/ANG-STRATEGJIA_P%C3%8BR_P%C3%8BRFSHIRJEN_E_KOMUNITETEVE_ROM_DHE_ASHKALI_N%C3%8B_SHOQ%C3%8BRIN_KOSOVARE_2017-2021.pdf

¹⁵ http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/National_Strategy_for_Reintegration_of_Repatriated_Persons.pdf

Analizë kritike e qasjes drejt planeve strategjike

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021, zbaton qasje të mirëfilltë të bazuar në të drejtat e njeriut në nën-sektorin e arsimit para-universitar duke ia kushtuar përfshirjes dhe pjesëmarrjes njëzën nga shtatë fushat tematike. Megjithatë, e njëjta qasje nuk është përdorur për nën-sektorin e arsimit të lartë, e që është subjekt i këtij rishqyrtimi. Në fushën tematike të arsimit të lartë, vetëm një masë reflekton dimensionin e të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, kjo masë e vetme fokusohet në ofrimin e përkrahjes për një segment të grupeve të cënueshme dhe nuk arrin t'i parashohë përpjekjet gjithëpërfshirëse dhe sistematike të cilat do të rezultojnë me barazi për popullatën studentore në arsimin e lartë. Shikuar nga perspektiva e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut, PSAK nuk funksionon si strategji sektoriale gjithëpërfshirëse, por më shumë si një varg i ndërhyrjeve të copëtuara në nivele të ndryshme të arsimit, duke lënë anash nën-sektorë të rëndësishëm të arsimit të lartë, hulumtimin shkencor dhe zhvillimin e mësimdhënësve.

Plani Strategjik për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali ofron një qasje paksa më gjithëpërfshirëse dhe koherente në fushën e arsimit të lartë. Ai parasheh një varg masash që bazohen në nevojat e veçanta të grupeve të synuara. Dallimi kryesor në mes dy strategjive në nën-sektorin e arsimit të lartë është se kjo e fundit (Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali) është më tepër në përputhje me frymën pozitive dhe proaktive të Kushtetutës së Kosovës që bazohet në krijimin e barazisë në vend të masave të balancuara për të gjithë, duke mos përfillur nevojat e ndryshme të grupeve të ndryshme.

Aktet nënligjore të MASHT

Për qëllime të kësaj analize, aspektet dhe parimet e të drejtave të njeriut janë shqyrtuar në njëzet udhëzime administrative (UA) të MASHT-it të cilat rregullojnë arsimin e lartë. Secili nga këto udhëzime administrative rregullon një segment të Ligjit për Arsimin e Lartë apo një aspekt të sistemit të arsimit të lartë. Hulumtimi ka vështruar (i) përfshirja e përmbajtjeve që lidhen me të drejtat e njeriut në udhëzimet individuale administrative, apo (ii) zbatimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut, në dokumentet e shqyrtuara, gjatë adresimit të çështjeve të ndryshme në arsimin e lartë. Kështu, për shembull, është shqyrtuar UA 12/2018 për Njohjen e Diplomave për të kuptuar nëse adreson çështjet e komuniteteve etnike të Kosovës të cilët kanë diplomuar në vendet fqinje (*përmbajtja/dimensioni*), por gjithashtu nëse në niset nga perspektiva e të drejtave të njeriut gjatë adresimit të të gjitha çështjeve, siç është përfaqësimi i barabartë në komisione të ndryshme për njohje (*qasja/parimet*).

Siç u tha në pjesën e metodologjisë, gjatë analizimit të qasjes/parimeve të të drejtave të njeriut, studimi është përpjekur ta bëjë dallimin në mes dispozitave të udhëzimeve administrative që mëtojnë t'i trajtojnë çështjet në bazë të barabartë sipas parimit 'një masë për të gjithë' (pa bërë dallimin në bazë të nevojave individuale) dhe dispozitave të hartuara për të siguruar *barazi*, në bazë të nevojave konkrete të grupeve të caktuara.

¹⁶ http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/ANG-STRATEGJIA_P%C3%8BR_P%C3%8BRFSHIRJEN_E_KOMUNITETEVE_ROM_DHE_ASHKALI_N%C3%8B_SHOQ%C3%8BRIN%C3%8B_KOSOVARE_2017-2021.pdf

UA 12/2018, i cekur më lartë, për **Njohjen e Diplomave të Arsimit të Lartë** të fituara në institucionet e huaja të AL, nuk parasheh njohjen e diplomave të fituara në institucionet e arsimit të lartë të ish Jugosllavisë para vitit 1992 (Neni 3.16). Kjo lë të hapura një varg çështjesh për arsimim të mëtejshëm ose për punësim të anëtarëve të komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Në anën tjetër, kur përcakton anëtarësinë e Këshillit Shtetëror për Njohje, UA (Neni 5.2) rregullon vetëm fushat e studimit të përfaqësuara në këshill, por nuk përfshinë përbërjen etnike apo gjinore të Këshillit. Ky rregullim nuk mbështetë një qasje të barabartë ndaj faktorëve etnikë dhe gjinorë gjatë procesit të njohjes.

Dihet se komunitetet jo shqiptare në Kosovë janë prekur negativisht nga masat për njohje të diplomave të tyre nga periudha e para dhe pas luftës (të fituara në institucionet paralele të arsimit të lartë në gjuhën serbe si gjuhë e mësimdhënies), duke rezultuar me pamundësinë e tyre për të vazhduar studimet apo të punësohen. Kjo çështje është trajtuar pjesërisht nga udhëzimi administrativ i MASHT-it (UA) Nr. 09/2015 për **Pranimin e Diplomave të fituara në Republikën e Serbisë**. Neni 1 përcakton se në Kosovë, institucionet e arsimit të lartë do të vendosin për pranimin e këtyre diplomave për qëllime të studimeve të mëtutjeshme. Neni 3, në anën tjetër, përcakton se diplomat e lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë në Serbi për qëllime të punësimit do të pranohen nga organet e Kosovës. Zgjidhja kryesore e paraqitur në këtë nen është se diplomat e Serbisë do të pranohen, përmes një ndërmjetësi të njohur nga Shoqata Evropiane e Universiteteve (EUA). Megjithatë, ky UA nuk përfshinë pranimin e diplomave të fituara në institucionet e Kosovës të cilat punojnë sipas kornizës ligjore të Serbisë.

Neni 4 i UA 14/2017 për ndarjen e bursave për studentët e arsimit të lartë në Kosovë përcakton grupet të cilave u është dhënë prioritet në ndarjen e bursave. Shumica e grupeve të përfshira këtu janë ato që preken nga lufta e fundit në Kosovë dhe personat e privuar nga ana sociale. Studentet femra, grupet e nën-përfaqësuara, personat me nevoja të veçanta dhe anëtarët e grupeve etnike nuk janë përfshirë në grupet me prioritet. Praktisisht, kjo do të mund të thoshte se një studente e shkëlqyeshme rrome mund të mos zgjidhet për t'iu dhënë bursa, përkundër pjesëmarrjes jashtëzakonisht të ulët të tyre në arsimin e lartë dhe pozitës së vështirë në të cilën gjenden në shoqërinë kosovare.

Shembull i ngjashëm është hasur në UA për **Zgjedhjen e Studentëve në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj** i cili në asnjë rast nuk i referohet parimeve për zgjedhje, transparencë, pjesëmarrje, trajtim të barabartë apo paanshmëri. Si dispozitë ligjore e cila siguron një rregullore tjetër të USHA, ky UA duhej t'i referohej qartë dispozitave përkatëse ligjore që do të zbatoheshin me rastin e hartimit të rregullores së brendshme për zgjedhjen e studentëve në USHA në Ferizaj. Në Nenin 2.4 dhe 3.1.4, UA parasheh situatat e papritura dhe mënyrën e trajtimit të tyre nga Bordi Qeverisës. Megjithatë, autorët nuk kanë marrë në konsideratë ta këshillojnë udhëheqjen e universitetit për aspektet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut gjatë trajtimit të zgjedhjes së studentëve në Ferizaj. Çështjet si barazia gjinore dhe pjesëmarrja për të zgjedhur dhe për të qenë i/e zgjedhur, pjesëmarrja e komuniteteve etnike, pjesëmarrja e gjerë e organit të studentëve, përfaqësimi i barabartë për të gjitha grupet e studentëve, e kështu me radhë, do të ishin disa nga çështjet e rëndësishme që mund të adresoheshin në udhëzimin administrativ në fjalë. Dispozitat dhe parimet e njëjta janë zbatuar kur është rregulluar zgjedhja e studentëve në të gjitha pesë universitetet e reja publike (shih UA 02/2015, e kështu me radhë).

UA 16/2015 për **Themelimin dhe Funkionimin e Unionit të Studentëve në Republikën e Kosovës** përsëri përcakton fakte dhe procedura por nuk siguron një qasje gjithëpërfshirëse. Ai në dy raste i referohet çështjeve të pjesëmarrjes: në Nenin 5 kur i referohet anëtarësisë së Asamblesë së Përgjithshme dhe në Nenin 9.1.2 lidhur me përbërjen gjinore të dy nënkryetarëve (duke siguruar përfaqësim të barabartë mashkullor dhe femëror). Në rastin e parë, ai parasheh që së paku një e treta e anëtarëve të Asamblesë

duhet të jetë e gjinisë femërore. Kjo normë gjinore është pa sqyrim i normave për përfaqësim të anëtarëve të gjinisë femërore në organe të ndryshme politike dhe administrative në Kosovë, përkatësisht në Parlamentin e Kosovës. Megjithatë, normal prej 33% në organet politike mund të shihet si përfaqësim i drejtë në situata kur gratë janë të nën-përfaqësuara si aktiviste politike. Në anën tjetër, norma prej 33% në organin përfaqësues të studentëve mund të konsiderohet tepër i ulët duke marrë parasysh faktin se studentet femra përbëjnë përafërsisht 50% të trupës studentore.

Përveç kësaj, ky udhëzim administrativ adreson çështjen gjinore, ndërsa lë pa përfshirë aspekte të rëndësishme siç janë komunitetet etnike, grupet e cenueshme, studentët me nevoja të veçanta, e kështu me radhë. Mungesa e këtyre dispozitave tashmë mund të ketë pasur ndikim negativ në natyrën e angazhimit dhe në shkallën e përfshirjes në Unionin e Studentëve të Kosovës. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të vështrohen iniciativat dhe vendimet e USK, pjesëmarrja në ngjarjet e tyre kryesore, prania e aktiviteteve që synojnë grupet e cenueshme, e kështu me radhë. Përveç pjesës që mungon lidhur me grupet e ndryshme dhe me komunitetet, UA i mungojnë temat dhe aktivitetet që USK do t'i ndër marrë duke inkorporuar qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut në veprimet e USK-së.

UA 15/2014 për **qendrën e studentëve (konviktet)** parasheh stimulime për kategori të ndryshme për të jetuar në qendrën e studentëve. Udhëzimi i jep prioritet kategorive që lidhen me luftën e fundit, për studentët MNV si dhe për studentët të privuar në aspektin ekonomik dhe social. Megjithatë, ky UA nuk parasheh ndonjë stimul për studentet femra, anëtarët e komuniteteve etnike dhe anëtarët e grupeve të cenueshme (siç janë studentët e kthyer).

UA Nr. 09/2016 parasheh zbatimin e **masave pozitive dhe vendet e rezervuara** për regjistrimin e kandidatëve nga radhët e komuniteteve jo shumicë në institucionet publike të arsimit të lartë.¹⁷ UA parasheh kuotën për studentët e komuniteteve jo shumicë e cila arrin në 12% të numrit total të studentëve të regjistruar në njësitë akademike. Kuota e njëjtë e vendeve të rezervuara është paraparë edhe për banorët në Qendrën e Studentëve si dhe për mbështetje financiare për anëtarët e këtyre komuniteteve. Ky udhëzim administrativ vuan nga dobësia e njëjtë sikurse dokumentet tjera ligjore në kornizën ligjore për arsimin e lartë: ai ofron mbështetje sipas parimit 'një masë për të gjithë' i cili nuk merr parasysh nevojat e veçanta të komuniteteve të ndryshme. Për shembull, studentët rom nuk mund të ndjekin arsimimin e lartë në gjuhën e tyre në Kosovë apo në ndonjë shtet tjetër, siç është rasti me studentët nga radhët e komunitetit serb, boshnjak dhe turk.¹⁸ Ky UA përmban dispozita të cilat mbrojnë nga rastet e keq-përfaqësimit kur anëtarët e komunitetit shumicë abuzojnë me këtë rregullore - dhe kuota e rezervuar - për të fituar vende për studim në programet e studimeve që janë shumë të kërkuara.

Shembuj të tjerë mund të paraqiten nga mesi i njëzet udhëzimeve administrative të MASHT-it të analizuara, të cilat ilustrjnë qasjen e pastër teknike dhe akademike, në dëm të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut. Udhëzimi Administrativ 28/2016 për grantet afatshkurta të mobilitetit dhe për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare adreson vetëm aspektet teknike dhe akademike të mobilitetit dhe konferencave ndërkombëtare, duke neglizhuar nevojën për të siguruar ndonjë masë afirmative për anëtarët e grupeve të ndryshme të nën-përfaqësuara bazuar në nevojat e tyre të veçanta. Autorët e këtij udhëzimi administrativ duket të kenë qenë të përqendruar në mënyrat se si të shmangen keqpërdorimet e ndryshme të fondeve por nuk kanë arritur të garantojnë një ambient lehtësues për personat apo grupet nevojtare, duke marrë në konsideratë faktorët gjinorë, etnik apo individual.

¹⁷ <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/06/ua-masht-09-2016-aplikimi-i-masave-afirmative-dhevendeve-te-rezal.pdf>

¹⁸ Dihet se ka raste kur anëtarët e shumicës shqiptare regjistrohen në studime brenda kësaj kuote në programet të cilat janë shumë të kërkuara në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.

Manuali i Akreditimit i Agjencisë Kosovare për Akreditim¹⁹

Manuali i Akreditimit i AKA (Kosovo Accreditation Agency, 2018) është dokument i rëndësishëm për çdo dimension të arsimit të lartë pasi që përveç karakterit të tij rregullues, parasheh gjithashtu monitorimin dhe mbrojtjen dhe implementimin e standardeve të parapara. Ai parasheh gjithashtu tregues të veçantë të cilët institucioneve ua bëjnë më të lehtë ta kuptojnë se çka kërkohet prej tyre për t'i plotësuar standardet. Manuali është i domosdoshëm të konsultohet nga të gjitha institucionet kur aplikojnë si për akreditim institucional ashtu edhe për akreditim të programeve në AKA. Manuali përmban disa standarde dhe tregues që mbështesin zbatimin e të drejtave të njeriut në programet dhe institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. Një pjesë e tërë, si në komponentin e akreditimit institucional ashtu edhe në atë të akreditimit të programeve, i kushtohet rregullimit të çështjeve të studentëve dhe përkrahjes së tyre.

Krahas Kushtetutës së Kosovës, Manuali i Akreditimit i AKA është dokumenti kryesor i cili siguron një qasje më të fuqishme të bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin e lartë në Kosovë (Shih Aneksi 2 për pasqyrë të standardeve dhe treguesve që i kushtohen qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut lidhur me të drejtat e studentëve si dhe me praktikën e mësimdhënies dhe mësim-nxënies në IAL të Kosovës).

Manuali është i strukturuar në dy komponentë kryesor të vlerësimit: Vlerësimi institucioneve dhe vlerësimi i programeve studimore. Secili nga këta komponentë është i organizuar në (a) standarde dhe (b) tregues të performancës.

Manuali përmban disa standarde dhe tregues të performancës që kanë veçoritë e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut përmes praktikave afirmative të përkrahjes së studentëve në mësimdhënie, mësim-nxënie dhe në hulumtim në IAL. Fillimisht, të drejtat e njeriut pasqyrohen në pjesën që ka të bëjë me parimet e Manualit: “4. Sigurimi i cilësisë merr parasysh nevojat dhe pritshmëritë e studentëve, të gjithë akterëve tjerë dhe të shoqërisë (Manuali i Akreditimit, f. 7). Përveç parimeve, standardet individuale dhe treguesit parashohin qasje të bazuar në të drejtat e njeriut. Për ilustrim, Standardi 2.9. (Qeverisja dhe administrimi) mbulon përfaqësimin e studentëve në organet vendimmarrëse dhe në organe tjera duke përcaktuar se “Përfaqësuesit e studentëve janë anëtarë të të gjitha organeve vendimmarrëse, ekzekutive dhe konsultative. Mekanizmi për zgjedhjen e përfaqësuesve të studentëve shpjegohet qartë në rregulloret e brendshme. Ekziston një procedurë zgjedhore demokratike, transparente dhe jo-diskriminuese e cila nuk kufizon të drejtën e studentëve për të përfaqësuar dhe për t’u përfaqësuar. Institucioni nuk përfshihet në procesin e zgjedhjes së përfaqësuesve të studentëve.

Përveç kësaj, treguesi i performancës 1.5. në misionin dhe objektivat e Programit, përcakton se: “Koncepti i drejtësisë gjinore dhe promovimi i mundësive të barabarta për studentët në situata të tilla si, për shembull, studentët me dëmtime të lidhura me shëndetin, studentët me fëmijë, studentët e huaj, studentët me historik të emigrantëve dhe/apo studentët e familjeve të pafavorizuara në arsim, vihet në praktikë në nivelin e programit të studimit.” Kjo është dispozita më e avancuar e Manualit dhe për nga fryma e saj i ngjason qasjes së Kushtetutës së Kosovës.

¹⁹ <http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/accreditation-alb/standardet-e-akreditimit>

Analizë kritike e akteve nënligjore

Në përgjithësi, aktet nënligjore që rregullojnë nivelin e arsimit të lartë nuk parashohin masa pozitive dhe veprime afirmative për individët apo grupet e personave në pozita të pabarabarta sipas dispozitës dhe frymës kushtetuese. Udhëzimet administrative kryesisht fokusohen në aspekte teknike dhe akademike dhe, me përjashtime (Manuali i Akreditimit), nuk marrin në konsideratë nevojat e veçanta të rupeve të cenueshme apo çështjet gjinore. Shumica nga njëzet udhëzimet administrative të analizuara nuk adresojnë fare aspektet e të drejtave të njeriut, përveç nëse një aspekt i të drejtave të njeriut është temë kryesore apo subjekt i aktit nënligjor (siç është rasti me skemat për përkrahjen dhe bursat e studentëve, alokimi i vendosjes në konvikte, vendet e rezervuara për pakica, e kështu me radhë). Madje dhe kur rasti është i tillë, qasja është pothuajse tërësisht teknike dhe faktorët si përfshirja, barazia, pjesëmarrja e kështu me radhë, shpeshherë neglizhohen. Qasja më e zakonshme në trajtimin e të drejtave të njeriut është aranzhimet e tipit 'një masë për të gjithë' në kuptim të sigurimit të barazisë për të gjithë. Gjendja s'është tjetër veçse një pasqyrim i mënyrës se si Ligji për Arsimin e Lartë trajton të drejtat e njeriut - si temë e veçantë e shkëputur nga përmbajtja tjetër ligjore që adresohet nga Ligji.

Sidoqoftë, përjashtim interesant përbën Manuali i Akreditimit i AKA, i cili përcakton një numër të standardeve dhe treguesve të performancës që mund të shërbejnë si bazë për një qasje më koherente të bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin e lartë. Ky manual bëhet më i rëndësishëm për faktin se nga vlerësuesit e jashtëm për akreditim (zakonisht ekspertë ndërkombëtarë) pritet që t'i analizojnë me kujdes aplikimet për t'u siguruar se standardet dhe treguesit janë adresuar në mënyrë të drejtë. Aprovimi i tyre në vitin 2018 duhet të shihet si zhvillim i rëndësishëm në fushën e sigurimit të qasjes më koherente të bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin e lartë në Kosovë. **Një mënyrë e mundshme se si HERAS do të mund potencialisht ta mbështeste qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin e lartë në Kosovë, do të ishte duke ndihmuar institucionet e arsimit të lartë në plotësimin e kriterëve të manualit për akreditim.** Ndonëse është instrument i ri, për shkak të natyrës së tij të detyrueshme, pritet që Manuali i Akreditimit të AKA do të ketë ndikim pozitiv në proceset dhe praktikat e sistemit të arsimit të lartë të Kosovës dhe dispozitat e tij do të pasqyrohen çdoherë e më shpesh në ndryshimet e ardhshme të instrumenteve rregullatorë të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. Si përfundim, institucionet e arsimit të lartë, organet e arsimit, OJQ-të dhe ndërhyrjet e donatorëve të interesuar në përkrahjen e arsimit të lartë në Kosovë, duhet t'i kushtojnë vëmendje të afërt Manualit për Akreditim meqenëse ai paraqet aspekte të rëndësishme të cilat do të ndikojnë në trendet dhe zhvillimet në arsimin e lartë në Kosovë në vitet e ardhshme. E njëjta vlen për të gjitha palët e interesuara në mbështetjen e zbatimit të qasjes më koherente të bazuar në të drejtat e njeriut në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë.

Statutet e Universiteteve

Studimi është fokusuar kryesisht në Statutin e Universitetit të Prishtinës në radhë të parë për shkak se të gjitha universitetet e reja publike (madje edhe kolegjet private) i kanë hartuar statutet e tyre duke u bazuar në Statutin e Universitetit të Prishtinës që ka qenë në fuqi në kohën e themelimit të tyre (në mes vitit 2010 dhe 2015).

Statuti i Universitetit të Prishtinës²⁰ (Statuti këndej e tutje në këtë raport) zbaton qasje solide të bazuar në të drejtat e njeriut qysh në fillim duke përfshirë tre nene të veçanta (7, 8 dhe 9) që kanë të bëjnë me çështje dhe qasje ndaj të drejtave të njeriut.

Megjithatë, kur merret parasysh zbatimi i parimeve në pjesën hyrëse në dispozitat konkrete që rregullojnë funksionimin e universitetit, këto parime mungojnë pjesërisht ose tërësisht. Sa për ilustrim, dispozitat e Nenit 18 lidhur me anëtarësinë dhe funksionet e Bordit Qeverisës nuk adresojnë çështjen e barazisë gjinore apo mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët potencial, duke u fokusuar në vend të kësaj në aspekte akademike dhe në kualifikimet e anëtarëve. Mirëpo, nga aspekti pozitiv, paragrafi 9 i të njëjtit Nen parasheh pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve, ndonëse me kapacitet pa të drejt vote, në punën e Bordit. Kështu, ky nen huq dimensionin e përfshirjes, por fiton pika pozitive në dimensionin e pjesëmarrjes. Fryma e njëjtë karakterizon detyrat dhe përgjegjësitë e organeve kryesore të Universitetit (Bordi Qeverisës dhe Senati), emërimi dhe aprovimi i prorektorëve (Neni 36), dispozitat që kanë të bëjnë me Sekretarin e Përgjithshëm të Universitetit dhe kështu me radhë. Vetëm në rastin e përgjegjësi të Bordit Qeverisës, përmendet shkarazi zbatimi i dispozitave të përgjithshme të Statutit, e cila mund t'i referohet prapa dispozitave të Neneve 7, 8 dhe 9.

Fryma e këtyre neneve duket të mbetet e shkëputur nga dispozitat në vijim pasi që aspektet e të drejtave të njeriut siç janë paanësia, pjesëmarrja, barazia, mos-diskriminimi e kështu me radhë, nuk paraqiten askund tjetër në pjesët e mbetura të Statutit. Madje edhe situatat tipike që do të kërkonin përfaqësim të barabartë gjinor, siç janë zgjedhja e anëtarëve të Bordit Qeverisës, të Senatit, Këshillat e Fakulteteve, rektorëve, prorektorëve, dekanëve, prodekanëve, e kështu me radhë, nuk parashohin ndonjë masë për mbrojtje kundër diskriminimit. Me sa duket, ekziston mungesë e konsiderueshme e barazisë gjinore në anëtarësinë e të gjitha këtyre organeve. Dispozitat për pranimin e studentëve, të parapara në Nenet 103-106, trajtojnë kryesisht aspektet teknike të pranimit, por nuk parashohin ndonjë masë që do të krijonte kushte të barabarta (përfshirë infrastrukturën fizike dhe testimin) për të gjithë aplikuesit në bazë të nevojave dhe situatave të veçanta.

Fryma e njëjtë pasqyrohet në nenet (108-116) të cilat përcaktojnë vlerësimin dhe provimet e studentëve. Është e qartë se këto dy pjesë duhet të rishikohen për të ofruar një mjedis më tolerant për studentët me nevoja të veçanta arsimore dhe për studentët nga pakicat gjuhësore. Këto dy pjesë janë shumë të kujdesshme në përcaktimin e aspekteve teknike (siç janë studentët që nuk kalojnë provimin, përsëritja e vitit, ankesat, e kështu me radhë), por nuk parashohin asnjë masë (në formë të konsultimit, përkrahjes akademike apo teknologjike) për përmirësimin e performancës së studentëve, sigurimin e kushteve të njëjta të testimit për të gjithë, ofrimin e informimit dhe informatës kthyesë në kohë të duhur, e kështu me radhë. Neni 141, që trajton gjuhën e mësimdhënies përsëri merret krejtësisht me aspekte akademike dhe dështon ta njohë nevojën për dimensionin dhe qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut. Ky nen përcakton që Senati mund të vendosë për të organizuar studime në cilëndo gjuhë tjetër krahas gjuhës shqipe, por nuk parasheh ndonjë përkrahje për studentët nga grupe tjera gjuhësore gjatë ligjëratave apo vlerësimit të studentëve. Madje edhe të drejtat e studentëve, të parapara në Nenin 147, janë përsëri tërësisht akademike dhe administrative, duke i munguar kështu qasja e të drejtave të njeriut për nevoja të ndryshme të studentëve. Gjithashtu edhe ky nen, njeh në mënyrë mjaft sipërfaqësore të drejtën e studentëve për t'u ankuar, pasi që ai nuk siguron trajtim dhe përfaqësim të paanshëm të palëve në kontest. Nenet 156 - 162 që parashohin organizimin e studentëve përmbajnë vetëm një dispozitë (156.2) lidhur me mundësitë e barabarta dhe mos-diskriminimin kur i referohen statuteve të organizatave të studentëve. Interesant është fakti se kjo është e vetmja dispozitë e shkurtë që ofron një qasje më koherente të bazuar në të drejtat e njeriut pas Neneve 7, 8 dhe 9 në fillim të Statutit.

²⁰ <https://uni-pr.edu/inc/doc/statuti1.pdf>

Logjika e njëjtë është mishëruar në nenet që përcaktojnë çështjet e personelit (rekrutimi, promovimi dhe zhvillimi) dhe të financimit, tarifave të studentëve, administratën, bazën e të dhënave dhe raportimin. Disi, të tri 'nenet e të drejtave të njeriut' (7, 8 dhe 9) nuk duket se kanë peshën e duhur për të siguruar qasje koherente të bazuar në të drejtat e njeriut në Universitetin e Prishtinës. Duke marrë parasysh rëndësinë e Statutit të Universitetit në rregullimin e çështjeve në cilindo universitet, mund të arrihet në përfundim se ky Statut mund të mos ofrojë në mënyrë konsistente mundësi të barabarta, pjesëmarrje dhe përfaqësim të të gjithëve në Universitetin e Prishtinës.

Për qëllime të këtij studimi, Statutet e universiteteve tjera publike janë analizuar për ta vlerësuar praninë e të drejtave të njeriut dhe të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në këto institucione dhe për t'i krahasuar ato me qasjen e Universitetit të Prishtinës. Analiza tregoi se, me disa përjashtime të vogla, statutet tjera ishin pothuajse krejtësisht identike me Statutin e Universitetit të Prishtinës. Kjo dëshmohet me tre nenet për të drejtat e njeriut - të formuluar në të njëjtën mënyrë si ato të UP, me gjithsej numër të artikujve që është i ngjashëm me ato të UP (tri statutet kanë rreth 240 nene dhe tri kanë 220 nene), me formulimin e neneve dhe me qasjen dhe frymën e këtyre statuteve. Të drejtat e njeriut dhe vlerat janë prezentë në këto statute vetëm si përmbajtje në katër apo pesë nene, por nuk janë të integruara dhe përfshira nëpër dispozita si një qasje e përgjithshme dhe vlerë e dokumenteve kyçe në kornizën ligjore të këtyre institucioneve.

Analizë kritike e Statuteve të Universiteteve

Statuti i Universitetit të Prishtinës është i shkruar në një mënyrë e cila ndanë tërësisht të drejtat e njeriut nga çështjet akademike, shkencore dhe administrative. Qasja e aplikuar në Statutin e UP nuk reflekton një qasje koherente të bazuar në të drejtat e njeriut meqenëse nuk bën lidhjen në mes aspekteve kyçe funksionale të jetës së universitetit dhe aspekteve/parimeve përkatëse të të drejtave të njeriut. Fryma e neneve 7, 8 dhe 9, nuk reflektohet më tutje në asnjë nga dispozitat vijuese statutare, përveç të drejtës në ankesë. E qartë se e drejta në ankesë duhet të bashkohet me dispozitat tjera që shërbejnë për të parandaluar situatat e diskriminimit para se ato të ndodhin. Nevojitet një hulumtim më i hollësishëm i përqendruar në implikimet praktike të kësaj qasjeje për t'i identifikuar pasojat e kësaj qasjeje në rekrutimin e personelit, pranimet e studentëve, vlerësimin e studentëve, përfaqësimin e barabartë në udhëheqje dhe vende tjera, trajtim i paanshëm i ankesave dhe kështu me radhë.

Qasja e zbatuar në analizimin e statuteve të universiteteve për çështjet e universiteteve është krejtësisht akademike, duke i parë çështjet e të drejtave të njeriut të ndara nga çështjet tjera. Prandaj, të drejtat e njeriut janë fokusuar kryesisht në pjesët tjera të neneve, gjë që nuk mundëson një qasje të integruar apo përfshirjen e të drejtave të njeriut në tërë dokumentin. Ngjashëm me udhëzimet administrative, madje edhe nenet që përcaktojnë tarifave për studentë apo zgjedhjet e studentëve ruajnë qasjen teknike e cila synon të jetë mbrojtje kundër abuzimeve apo keq-menaxhimit. Karakteristikë tjetër e statuteve të universiteteve është fakti se përveç Statutit të Universitetit të Prishtinës, statutet tjera janë pak a shumë të ngjashme me vetëm disa ndryshime të vogla për ta pasqyruar situatën e tyre specifike.

IV. Zbatimi i QBDNj në universitetet publike

Zbatimi i parimeve të QBDNj në planifikimin e dokumenteve, rregullave dhe procedurave

Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës²¹

Për qëllime të këtij studimi, janë analizuar dokumentet e planifikimit strategjik të shtatë universiteteve publike. Plani Strategjik 2017 - 2019, (Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", 2017) i Universitetit të Prishtinës nuk parasheh ndonjë masë konkrete që do ta përkrahnin në mënyrë veçantë qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut në proceset e saj akademike. Du ket se është përgatitur për të adresuar çështje të efikasitetit dhe efektshmërisë të menaxhmentit dhe mësimdhënies e jo për ofrimin e mundësive të barabarta dhe të përvojave të mësim-nxënies për të gjithë studentët, përfshirë grupet e nën-përfaqësuar. Deklarata e misionit nuk fton asnjë komponent të aktiviteteve të tij që të adresojë aspektet e të drejtave të njeriut apo Dimensionin Social të Arsimit të Lartë të Procesit të Bolonjës. Në pjesën e quajtur "Strategjitë kryesore dhe iniciativat strategjike" është një strategji e cila kërkon "Të mësuarit për një botë me diversitet. Zbatimi i strategjive të reja për përmirësimin e diversitetit. Të nxisë një klimë mbështetëse dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë." Megjithatë, kjo strategji e cila duket se nënkupton një qasje ndërlidhëse, nuk duket se është përkthyer në aktivitete konkrete në planin e zbatimit bashkëngjitur Planit Strategjik.

Plani strategjik i UP-së adreson disa aspekte të rëndësishme të qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin e lartë, siç është pjesëmarrja e studentëve (si në vendimmarrje ashtu edhe në akreditim), adresimi i nevojave të veçanta arsimore të studentëve nevojtarë, sigurimi i shumëllojshmërisë dhe paanshmërisë në procesin e mësimdhënies dhe mësim-nxënies. Interesante është se këto dy dimensione hasen vetëm në nivel të planifikimit të veprimeve, pa u përmendur shumë (apo aspak) në nivel të qëllimeve dhe prioriteteve strategjike. Sidoqoftë, akoma tregon përkushtimin e UP-së që të ofrojë shërbime më të shumëllojshme për studentë. Hulumtime të mëtutjeshme do të tregojnë nivelin e zbatimit të tyre²².

Në një studim të vendimeve të Bordit Qeverisës të Universitetit të Prishtinës, i zhvilluar gjatë vitit 2017 dhe 2018, janë analizuar mbi 100 vendime të Bordit për ta vlerësuar cilësinë e vendimmarrjes në këtë universitet. Pjesa 'studim nga tavolina' e këtij studimi gjeti se pjesa më e madhe (mbi 80%) e këtyre vendimeve kishin të bënin me kërkesa të stafit akademik për pushim pa pagesë, rreth 10% ishin vendime administrative dhe në lidhje me programe (përfshirë heqjen e tarifave të studentëve) dhe tri vendime ishin në lidhje me planifikimin strategjik dhe qeverisjen. (Rexhaj, 2018). Përveç vendimeve që i referoheshin heqjes së tarifave të studentëve, ishte një rregullore për bursat e studentëve e cila vendoste për kategoritë e studentëve tarifave të cilëve mund të hiqen dhe për studentët të cilëve mund t'u ndahet bursa. Përveç këtyre, nuk kishte raste (vendime të Bordit Qeverisës të UP) që tregonin zbatim ose të pjesshëm ose të plotë të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut.

²¹ <https://www.uni-pr.edu/inc/doc/PLANI-STRATEGJIK1.pdf>

²²Universiteti i Prishtinës ka zhvilluar një vlerësim të nivelit të zbatimit të masave të planit të tij strategjik. Fatkeqësisht, përkundër përpjekjeve të përsëritura, ekipi hulumtues nuk ka arritur t'i sigurojë rezultatet e atij vlerësimi.

Plani Strategjik i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren²³

Plani Strategjik 2018-2022 (Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, 2018) përdorë logjikë dhe strukturë të ngjashme sikurse plani strategjik i Universitetit të Prishtinës²⁴ - që në fakt është qasje më pak e zakonshme në proceset e planifikimit strategjik në ditët e sotme.²⁵ Së pari janë prioritetet strategjike, të përcjella nga qëllimet strategjike dhe pastaj fushat strategjike dhe iniciativat. Fushat strategjike dhe iniciativat zbërthehen më tej në objektiva strategjike dhe nganjëherë si masa. Strategjia aprovohet në nivel të universitetit, ndërsa nga njësitë akademike kërkohet ta shtjellojnë atë më tutje gjatë zhvillimit të planeve të tyre operacionale dhe periodike.

Duket se këto dokumente nuk kanë përfshirë fushat e intervenimit dhe objektivat strategjike (nganjëherë ato quhen prioritetet strategjike dhe nganjëherë qëllime) dhe mungon koherenca në mes prioritetëve, qëllimeve dhe masave. Për shembull, diversiteti gjuhësor është përfshirë në mesin e Prioritetëve Strategjike, por nuk është reflektuar më tutje në 'iniciativat' strategjike. Vetëm një aktivitet i Fakultetit të Edukimit adreson nevojat e studentëve për mësim-nxënie, ndërsa fakultetet tjera janë fokusuar në çështjet akademike, të menaxhimit, zhvillimit të personelit dhe të infrastrukturës. Madje edhe në raste kur masat strategjike dhe aktivitetet fokusohen në studentë, kjo më shumë bëhet me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes apo të përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies dhe jo drejtpërsëdrejti për të ofruar paanësi apo mbështetje për ta përmirësuar mësim-nxënien.

Universiteti në Prizren është universitet rajonal që ofron shërbime të arsimit të lartë në një regjion të banuar me mbi 80% të komuniteteve etnike joshqiptare dhe jo-serbe të Kosovës. Duke pasur këtë parasysh, do të ishte e domosdoshme që Universiteti i Prizrenit të jetë i vëmendshëm për çështjet e komuniteteve etnike dhe të drejtave të njeriut dhe t'i kushtojë objektiva të ndara strategjike dhe politika që kanë të bëjnë me elemente të të drejtave të njeriut dhe të sigurojë qasje të bazuar në të drejtat e njeriut e cila prekë të gjitha funksionet kryesore të universitetit. Duket se nuk është rasti kështu në dokumentet strategjike dhe dokumentet tjera të analizuara gjatë këtij studimi.

Plani Strategjik 2017-2022²⁶ i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan

Ky Plan Strategjik (Universiteti "Kadri Zeka" Gjiilan, 2017) përcakton prioritetet strategjike dhe qëllimet e Universitetit për periudhën gjashtë vjeçare. Ai përvijon gjithashtu sfidat kryesore me të cilat përballet në orvatjet e tij për arritjen e vizionit dhe misionit të caktuar. Një nga prioritetet kryesore të UKZ është lidhja me industrinë dhe shoqërinë. Prioriteti i njëjtë e sheh mbështetjen kryesore për studentë përgatitja e tyre për punësim në tregun e punës. Kjo është qasja e përgjithshme ndaj studentëve në tërë planin strategjik. Pjesa e strategjisë që është në dispozicion online, nuk jep shfaq ndonjë indikacion të një përpjekje sistematike drejt qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut. Çdo marrje parasysh e çështjeve të studentëve është trajtuar shka razi dhe nga perspektiva akademike apo e tregut të punës.

²³ <https://uni-prizren.com/sq/planet-strategjike-upz>

²⁴ Në fakt pjesët janë kopjuar nga strategjia e UP-së (për ilustrim, shih tetë fushat strategjike dhe pjesën Monitorimi).

²⁵ Nuk është e qartë nëse është bërë ndonjë analizë e situatës (SWOT). Një nga masat e njësive akademike është plani për të themeluar programin e doktoratës (PhD) në një nga departamentet me mungesë të konsiderueshme të stafit akademik! Duket se nuk është marrë në konsideratë qasja e kornizës logjike. Gjithashtu, nuk ka tregues se ka pasur ndonjë mbledhje të veçantë të të dhënave për këtë ushtrim!

²⁶ <https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2017/05/Strategjia-e-UKZ.pdf>

Pavarësisht mungesës së një qasjeje më sistematike të bazuar në të drejtat e njeriut, plani strategjik i UKZ duket se akoma ka studentët në mesin e pikave kryesore të të menduarit të tij strategjik. Sa për ilustrim, prioriteti i parë për lidhjen me industrinë dhe shoqërinë, i kushton rëndësi të duhur pajisjes së studentëve me shkathhtësitë e nevojshme për tregun e punës; prioriteti strategjik i dedikuar studentëve ka të bëjë me krijimin e kushteve për rritjen e numrit të regjistrimeve dhe përmirësimin e mobilitetit të studentëve. Edhe pse kjo qasje nuk është e barabartë me qasjen tipike të bazuar në të drejtat e njeriut (që fokusohet në barazi, çështje gjinore, mbështetje për nevojat e veçanta dhe kështu me radhë), megjithatë ajo përpiqet të adresojë disa çështje të studentëve, siç janë ofrimi i shërbimeve të bibliotekës, ofrimi i literaturës, kushteve të punës, e kështu me radhë. Në përfundim, Universiteti Kadri Zeka në Gjiilan do të mund të investonte më shumë kohë dhe përpjekje për përfshirjen e qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut nëse synon përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të tij akademike, hulumtuese dhe për komunitetin. Nevojitet të bëhet shumë për përmbushjen e kësaj objektivë. Në periudhën afatshkurtër, sikurse universitetet tjera, UKZ do të duhet ta rishikojë strategjinë e tij për ta bërë atë më miqësore ndaj studentëve dhe për të ofruar një ambient më të përshtatshëm për mësim-nxënje dhe hulumtim për të gjithë.

Në rastin e Universitetit të Gjiilanit, ekipi i hulumtimit ka analizuar të gjitha rregulloret dhe vendimet e publikuara në uebfaqen e universitetit. Administrata e Universitetit ka publikuar ²⁷ dokumentet kryesore të lëshuara nga menaxhmenti, përfshirë vendimet e Bordit, rregulloret, planet e veprimit të njësisë akademike dhe kështu me radhë që nga fillimi i funksionimit të tij. Prej 28 rregulloreve dhe vendimeve të publikuara në uebfaqe, 13 sosh rregullojnë çështjet akademike dhe 15 tjera rregullojnë çështjet administrative dhe financiare.

Vendimet institucionale tregojnë më shumë një qasje akademike ndaj çështjeve të të drejtave të njeriut pasi që kryesisht adresojnë aspektet akademike të personelit dhe studentëve në universitet. Këto janë kryesisht vendime që rregullojnë kurrikulën, studimet, organet punuese, zgjedhjet e studentëve dhe të personelit, e kështu me radhë. Ato nuk adresojnë të drejtat e njeriut as si përmbajtje kryesore (për shembull një rregullore për të siguruar përfshirjen e personave me nevoja të veçanta) e as si çështje ndër-sektoriale e rregulloreve që merren krejtësisht me çështje akademike (për shembull dispozitat që përcaktojnë përfaqësim të barabartë në komisione dhe panele të ndryshme).

Për ta vlerësuar më mirë status quo-në, Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhje në UKZ (Prill 2016) është analizuar më hollësisht.²⁸ Shumica e dispozitave përcaktojnë rregullat dhe procedurat me një gjuhë neutrale. Përfundimisht në Neni 10, i cili parasheh se në rastet e kandidatëve të barabartë për pozitën e njëjtë, kandidatet femra do të kenë përparësi. Zgjidhja e njëjtë përsëritet lidhur me zgjedhjen e kandidatëve me numër të njëjtë të votave. Sidoqoftë, nuk është krijuar asnjë dispozitë tjetër për të siguruar pjesëmarrje të barabartë gjinore, nga komuniteti apo studentët në panele dhe komisione të ndryshme, në organe punuese përgjegjëse për ndonjë aspekt të caktuar të zgjedhjeve apo madje si mjet të theksimit të së drejtës së barabartë për t'u zgjedhur.

Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë ²⁹ përdorë të njëjtën qasje ndaj të drejtave të njeriut: ato nuk janë në fokus të dispozitave të saj dhe janë integruar vetëm në masë të kufizuar. Neni 8, që përcakton anëtarësinë e Komisionit të Universitetit për Sigurim të Cilësisë parasheh përfshirjen e klasave kryesore (personelit akademik, administratës dhe studentëve), por nuk arrin të adresojë përfaqësimin gjinor, personat me nevojat të veçanta dhe komunitetet etnike, nëse ka të tilla.

²⁷ <https://www.uni-gjilan.net/universiteti/dokumentet-e-rendesishme/>

²⁸ Kjo rregullore është zgjedhur për shkak se është dokument tipik i cili mund të adresojë çështje të ndjes hme si ato gjinore, të barazisë dhe të komunitetit. <https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2019/04/RREGULLAT-DHE-PROCEDURAT-PER-ZGJEDHJET-E-PERGJITHSHME-NE-UKZ.pdf>

*Plan Strategjik 2015- 2020 i Universitetit të Gjakovës*³⁰

Plani Strategjik (Universiteti i Gjakoves "Fehmi Agani", 2015) i Universitetit të Gjakovës është krijuar në bazë të një procesi pjesëmarrës dhe në qasjen e kornizës logjike. Prandaj, ai përfshinë pesë fusha të intervenimit, pesë objektiva strategjike, mbi 50 masa strategjike dhe aktivitete të cilat shërbejnë për përmbushjen e objektivave të vendosura. Ngjashëm me universitetet tjera, Plani nuk siguron një qasje gjithëpërfshirëse dhe sistematike të bazuar në të drejtat e njeriut, por ofron disa masa strategjike të cilat reflektojnë disa parime të caktuara të të drejtave të njeriut. Sa për ilustrim, Plani parasheh Qendrën për Këshillim në Karrierë (Masa 2.3.), Qendrën për Mësim gjatë gjithë jetës (M 2.4), një portal për të lehtësuar komunikimin me studentë (M 3.2), dhe një varg të aktiviteteve për përkrahje të studentëve për përmirësimin e performancës së studentëve (M 3.4).

Megjithatë, edhe ky plan strategjik, nuk është i barabartë me një qasje sistematike e cila në mënyrë të veçantë do të adresonte çështjet gjinore, të komunitetit, të nevojave të veçanta dhe të tjera me të cilat përballen studentët gjatë studimeve të tyre. Ai nuk parasheh as masa të veçanta që synojnë grupet e marginalizuara, gjë që e bën të ngjashëm me planet tjera të analizuar për universitetet tjera. E rëndësishme bëhet që të mësohet nëse masat e parapara në këtë plan zbatohen ashtu si janë cekur në planin e implementimit. Në këtë drejtim, një analizë e shpejtë e vendimeve të menaxhmentit të UGJ-së të publikuara në uebfaqen e institucionit³¹ shpërfaqë një qasje më shumë akademike dhe e ndihmës sociale ndaj çështjeve të studentëve. Nga 38 vendime të Bordit Qeverisës gjatë vitit 2019, vetëm tri sosh adresojnë çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut: një për krijimin e Qendrës për Këshillim në Karrierë dhe për Alumni, një tjetër për heqjen e tarifave për studim të kategorive të caktuara të studentëve dhe një vendim për bursat e studentëve. Nuk ka asnjë vendim (që fokusohet tërësisht në të drejtat e njeriut) që do të mundësonte qasje më sistematike dhe institucionale ndaj aspekteve të të drejtave të njeriut siç janë barazia, paanësia, çështjet gjinore, nevojat e veçanta për arsimim, e kështu me radhë. Qasja e vendimeve tjera është krejtësisht administrative dhe/ose akademike dhe nuk reflekton aspektet e të drejtave të njeriut apo dimensionin social. Dy vendimet të lëshuara nga rektori e të publikuara në uebfaqe janë administrative për nga natyra, ndërsa prej 19 vendimeve të publikuara të Senatit të Universitetit vetëm një adreson çështje të bursave të studentëve (duke ulur kështu mesataren e pragut të notave). Madje edhe ky i fundit nuk përmban një arsyetim ligjor që do të tregonte motivet (potencialisht përfshirëse) prapa një vendimi të tillë.

²⁹ Rregullorja për Procedurat e Sigurimit të Cilësisë, Ref. 01/380 e Majit 2016. <https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2016/05/Rregullore-p%C3%ABr-procedurat-e-sigurimit-t%C3%AB-cil%C3%ABsis%C3%AB.pdf>

³⁰ https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/Plani_strategjik_per_web.pdf

³¹ <https://uni-gjk.org/dokumentet/kd>

Plani Strategjik 2018-2021 i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini"

Ky plan strategjik (Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini", 2018) aplikon qasje të ngjashme të planifikimit me atë të Universitetit të Prishtinës. Fillon me prioritetet strategjike, për të vazhduar me qëllimet strategjike dhe më tutje me iniciativat strategjike. Sidoqoftë, ndryshe nga universitetet tjera dhe deri në një masë, ngjashëm me Universitetin e Gjakovës, kjo strategji fokusohet më shumë në çështjet e studentëve. Plani ia kushton një iniciativë të tërë strategjike (2. Burimet e mësim-nxënies dhe shërbimet mbështetëse për studentë) çështjeve të studentëve. Në këtë dhe në masa tjera strategjike, Plani parasheh masa që fokusohen në përmirësimin e shërbimeve mbështetëse për studentë, në përmirësimin e performancës së studentëve dhe në pjesëmarrjen e tyre në aktivitete për mësim-nxënie dhe vendimmarrëse. Sidoqoftë, sikurse planet tjera të analizuara deri më tani, ai gjithashtu nuk arrin të zbatojë një qasje më sistematike të bazuar në konceptin e të drejtave të njeriut. Kështu, çështjet gjinore, nevojat e veçanta, çështjet e komunitetit, të grupeve të marginalizuara, e kështu me radhë mbeten të një rëndësie të vogël në këtë strategji, gjithashtu. Si përfundim, ky Plan do të mund të lavdërohej për përqendrimin e tij në çështjet studentore por ngec në aspektin e një qasjeje më gjithëpërfshirëse të bazuar në të drejtat e njeriut për të ofruar paanësi dhe përsosmëri për të gjithë. Mbetet të shihet nëse aktivitetet e parapara në prioritetin e dytë strategjik janë implementuar ashtu si janë paraparë apo jo.

Vlen të ceket në vërejtjet përfundimtare të kësaj pjese se Universiteti i Pejës është në proces të hartimit të planit të tij të ri strategjik 2020-2024 dhe se qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut dhe Dimensionit Social të Bolonjës i është kushtuar rëndësia e duhur në fazën e hartimit.

Analizë kritike e zbatimit të QBDNJ-së në planet strategjike dhe në rregullore

Emërtues i përbashkët i planeve strategjike është se masat të cilat bien në fushën e të drejtave të njeriut i parashohin vetëm në nivel të aktiviteteve konkrete. Ekziston mungesë e konsiderueshme e ofrimit të të drejtave të njeriut në nivel më të përgjithshëm të vizionit, misionit apo objektivave strategjike. Prandaj, kushdo që vështron praktikatat e të drejtave të njeriut në planet strategjike të universiteteve publike të Kosovës, më tepër duhet të vlerësojë planet vjetore të veprimit të njësive akademike se sa pjesën me më shumë konsiderata strategjike. Kjo mungesë e një qasjeje më gjithëpërfshirëse përkthehet në një numër të kufizuar të aktiviteteve *konkrete* në fushën e të drejtave të njeriut, por edhe në mungesë të *qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në planet strategjike dhe në institucionet e arsimit të lartë*. Si rezultat, intervenimet që do të merreshin me promovimin e çështjes gjinore, sigurimit të barazisë dhe ofrimit të mbështetjes për personat me nevojat të veçanta, ndodhë më shumë në baza *ad hoc* e jo si pjesë e një qasjeje më sistematike. Universitetet duhet të mendojnë seriozisht për një qasje më proaktive në këtë drejtim nëse synojnë ta përmirësojnë performancën e studentëve, ta përmirësojnë mjedisin e mësim-nxënies dhe të plotësojnë më mirë pritshmëritë e shoqërisë nga ta si institucione edukativo-arsimore.

Intervistat me personelin e universitetit: Prezantimi i gjetjeve

Ekipi i HERAS që ka punuar në këtë studim ka intervistuar gjithashtu anëtarët e menaxhmentit dhe personelit të universiteteve publike. Çështjet kryesore që janë diskutuar ishin prezenca e të drejtave të njeriut dhe implementimi i qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në: mësimdhënie, kurrikulë, materialet për mësimdhënie, ankorimi institucional i të drejtave të njeriut, bashkëpunimi me OJQ-të në fushën e të drejtave të njeriut, niveli i politikave dhe ekzistimi i përpjekjeve për ndërtimin e kapaciteteve (apo programeve) në fushën e të drejtave të njeriut.

Në përgjithësi, intervistat me stafin treguan qasje të copëzuar ndaj të drejtave të njeriut në universitetet publike në Kosovë. Zakonisht, të drejtat e njeriut adresohen në mënyrë josistematike, përmes lëndëve individuale, nga profesorë individual, duke përdorur materiale të pakta të mësimdhënies dhe me mungë të një qasjeje institucionale. Për arsye të ndryshme (përfshirë përvojën më të gjatë dhe mbështetjen e konsiderueshme ndërkombëtare), Universiteti i Prishtinës duket të jetë në një pozitë më të mirë edhe sa i përket zbatimit të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në proceset akademike, hulumtuese dhe administrative në Universitet. Një nga përparësitë kyçe të Universitetit të Prishtinës është ekzistimi i Qendrës për të Drejtat e Njeriut në kuadër të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës (detaje shtesë në vijim).

Më tutje në këtë pjesë, janë paraqitur gjetjet kryesore nga intervistat me personelin e universitetit.

Mësimdhënia: Kur është diskutuar mësimdhënia, respondentët dhanë përgjigje të përziera, disa prej tyre pohuan mungesën e qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në mësimdhënie dhe të aspekteve që lidhen me qasjen e mësimdhënies me studentin në qendër. Megjithatë, nuk i është referuar asnjë rregulloreje e cila do t'i mbështeste pretendimet për mësimdhënie me studentin në qendër. Edhe nëse qasja me studentin në qendër është pranuar si element i rëndësishëm i qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në mësimdhënie, prapëseprapë nuk mjafton për ta mbuluar komunikimin mësimdhënës-student, vlerësimin e studentëve, dimensionin e mbështetjes së studentëve, dhënia e informatës kthyesë dhe reagimi në vlerësimet e studentëve. Rasteve të hasura në universitete të ndryshme u mungojnë prova të forta të ndonjë orvatje të qëndrueshme sistematike për të zbatuar qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut në mësimdhënie. Për ilustrim, *“Mësimdhënia në institucionin tonë është e ndjeshme ndaj aspektit të të drejtave të njeriut, e gatshme për promovimin e barazisë - paanësisë, barazisë gjinore me tërë ndjeshmërinë dhe zgjuarsinë përmes organizimit të aktiviteteve dhe programeve që kanë të bëjnë me çështjet e të drejtave të njeriut.”* Megjithatë, kjo nuk mbështetet me dëshmi në formë të politikave dhe praktikave konkrete. Zakonisht, në përpjekje për të ilustruar zbatimin e qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në mësimdhënie, respondentët i referohen aspektit të barazisë gjinore, anëtarët e dy institucioneve (UP dhe UMIB) i referohen paanësisë dhe barazisë, dhe dy institucione tjera i referohen mësimdhënies me studentin në qendër. Megjithatë, opinioni kritik i një të anketuari duket të jetë më afër realitetit: *“Sidoqoftë, duhet theksuar se shpeshherë ligjëratat nuk i kushtojnë vëmendje të posaçme të drejtave të njeriut. Për ilustrim, ata nuk i kushtojnë vëmendje çështjeve që përfshijnë barazinë gjinore, diskriminimin, etikën, lirinë e fjalës, gjykimin e paanshëm, të drejtat e privatësisë dhe kështu me radhë, dhe si rezultat ka shumë stereotipa, paragjykimi në baza gjinore, etj. Në vend të kësaj, mësimdhënia duhet të synojë lehtësimin e të kuptuarit në mesin e studentëve se çka përbën shkëlqje të të drejtave të njeriut në sektorin publik dhe në atë privat, llogaridhënia e administratës publike, liria e fjalës, e drejta në privatësi, e drejta për zhvillim, e kështu me radhë.”*

Kurrikula

Sipas mësimdhënësve dhe personelit të anketuar në studimin HERAS, kurrikula adreson vetëm pjesërisht çështjet e të drejtave të njeriut. Qasja ndaj të drejtave të njeriut në kurrikulat e universiteteve publike është e fragmentarizuar, për faktin se vetëm disa fakultete përfshijnë **lëndë apo përmbajtje për të drejtat e njeriut** në kurrikulat e tyre. Apo, siç u deklarua nga një i anketuar nga Universiteti i Gjilanit: *“Ne nuk ofrojmë diplomë të plotë në edukimin për të drejtat e njeriut, por të drejtat e njeriut i kemi paraparë si pjesë e kurrikulës, për shembull, të lidhura me temat e të drejtave të njeriut si historia, politika dhe shtetësia, zhvillimi, shoqëria, sociologjia, zhvillimi lokal, zgjedhjet, sundimi i ligjit, etj.”* Në mënyrë tipike, të drejtat e njeriut janë të përfshira në kurrikulë të fakulteteve të edukimit, të juridikut dhe, nganjëherë, në programet studimore ekonomike dhe sociale. Ngjashëm me gjetjet e një studimi të mëhershëm nga HERAS

(Loxha, 2018), zakonisht fakultetet juridike përfshijnë një qasje normative ndaj të drejtave të njeriut, ndërsa fakultetet e edukimit më shumë anojnë drejt një qasjeje më shumë edukative për zbatimin e të drejtave të njeriut në sektorë të ndryshëm të jetës në Kosovë. Në shumicën e rasteve, lëndët për të drejtat e njeriut të ofruara në këto fakultete nuk janë në dispozicion për studentët e fakulteteve tjera të universitetit të njëjtë, qoftë si lëndë zgjedhore apo fakultative. Kjo nënkupton se lëndët dhe përmbajtjet për të drejtat e njeriut janë në dispozicion vetëm për një numër të kufizuar të studentëve në universitete.

Sipas një të anketuari nga një prej universiteteve të reja, përmbajtja dhe lëndët për të drejtat e njeriut në fakultetet e edukimit dhe të shkencave shoqërore përfshijnë lëndët si: Të drejtat e njeriut, Të drejtat e pakicave, Sociologjia e familjes dhe e drejta ligjore, Konfliktet dhe zgjidhja e tyre, Edukata qytetare, Familja dhe edukimi parashkollor. Të anketuar të tjerë pohojnë se fakultetet juridike përfshijnë lëndët si: E drejta ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Organizatat ndërkombëtare, me fokus në rolin e OKB-së dhe në rolet e Këshillit të Evropës në DNJ, E drejta ndërkombëtare publike, ku mbulohej të gjitha marrëveshjet dhe konventat për të drejtat e njeriut, E drejta evropiane dhe Konventa për të Drejtat Themelore të Njeriut në BE, Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe gjithashtu Ligji Ndërkombëtar Humanitar. Në fushën e biznesit dhe ekonomisë, kryesisht ka lëndë që kanë të bëjnë me etikën dhe të drejtën e biznesit.

Ngjashëm me kurrikulë, materialet e mësimdhënies përbëhen kryesisht nga tekste shkollore universitare që mbulojnë të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të drejtat gjinore dhe të familjes. Literatura për të drejtat e njeriut në këto universitete përfshinë një listë të konsiderueshme të teksteve shkollore si nga autorë vendorë ashtu edhe nga ata ndërkombëtarë (përfshirë Zejnullah Gruda, Jordan Daci dhe të tjerë). Temat e mbuluara nga këto tekste përfshinë pozitën e grave në Kosovë (me vështrim të posaçëm në të drejtën zakonore), E drejta evropiane për të drejtat e njeriut, shkrimi i grave, të drejtat e grave, mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, edukimi për të drejtat e njeriut në Kosovë, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut dhe të tjera. Lista e literaturës për të drejtat e njeriut nuk përfshinë ndonjë broshurë, fletushkë, afishe, apo publikime që i referohen zbatimit të të drejtave të njeriut në proceset dhe praktikat e universitetit.

Ankorimi institucional i të drejtave të njeriut

Ekzistojnë dy mënyra me të cilat të drejtat e njeriut janë ancoruar në mjedisin institucional të universiteteve publike të Kosovës: politikat / planet strategjike dhe mekanizmat institucionale.

Aspekti i politikave / planifikimit strategjik është adresuar më hollësisht më sipër duke treguar qasje relativisht jokoherente dhe josistematike ndaj të drejtave të njeriut, për faktin se mezi ishte përfshirë në objektivat dhe qëllimet strategjike, por shfaqet në nivel të masave dhe aktiviteteve deri në një masë, dhe pastaj pak a shumë zhduket përsëri në fazën e zbatimit.

Sa i përket mekanizmit institucional, janë dy institucione që merren drejtpërsëdrejti me çështjet e të drejtave të njeriut në dy prej universiteteve publike në Kosovë: Së pari, Qendra për të Drejtat e Njeriut e Universitetit të Prishtinës, që funksionon në kuadër të Fakultetit Juridik që nga 2002. Së dyti, Instituti për Hulumtimin e Sundimit të Ligjit dhe për të Drejtave të Njeriut i themeluar në vitin 2017 në kuadër të Universitetit Haxhi Zeka në Pejë.

Qendra për të Drejtat e Njeriut e Universitetit të Prishtinës ofron aktivitete dhe shërbime për të drejtat e njeriut. Qendra për të Drejtat e Njeriut e Universitetit të Prishtinës ka qenë pikë qendrore me portfolio të pasur në fushën e të drejtave të njeriut jo vetëm në Universitetin e Prishtinës. Ka qenë i angazhuar në dizajnimin dhe publikimin e materialeve, publikimeve dhe rezultateve të hulumtimeve në fushën e të drejtave të njeriut. Përveç kësaj, portfolio e saj është e pasur për nga organizimi i ngjarjeve në fushën e të drejtave të njeriut, shënimin e datave të rëndësishme që lidhen me të drejtat e njeriut, ofrimin e ligjëratave dhe trajnimeve nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, e kështu me radhë. Uebfaqja e QDNJ tregon numër të konsiderueshëm të aktiviteteve të organizuara gjatë vitit 2019. Është e qartë se me përkrahje më adekuate nga Universiteti dhe nga autoritetet e arsimit në Kosovë QDNJ do të mund të luante rol edhe më të rëndësishëm në avancimin e të drejtave të njeriut jo vetëm në Universitetin e Prishtinës por edhe përtej tij.

Sipas të anketuarve nga UP, "Qëllimi kryesor i institucionit është organizimi i aktiviteteve drejtpërsëdrejti të lidhura me çështjet e të drejtave të njeriut. *Qendra për të Drejtat e Njeriut që nga viti 2002 ka organizuar dhe vazhdon të organizojë deri në ditën e sotme aktivitete të ndryshme siç janë konferenca, punëtori, debate, kurse dhe shumë aktivitete në bashkëpunim me OJQ të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare dhe me universitete.*" Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës përfshinë edhe një institucion tjetër, përkatësisht Qendra e Burimeve për Drejtësi Tranzicionale, që shërben për adresimin e aspekteve shumë të rëndësishme ligjore të të drejtave të njeriut (çështjet gjinore, e drejta pronësore, drejtësia post konfliktit, etj.). Në situata kur ka mungesë të konsiderueshme të çfarëdo mekanizmi institucional në fushën e të drejtave të njeriut në institucionet publike (apo edhe private) të arsimit të lartë në Kosovë, duket praktike të pritët që Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe objektet tjera në Universitetin e Prishtinës të arrijnë tek studentët dhe personeli në universitetet tjera me materiale, ngjarje dhe aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve në fushën e të drejtave të njeriut.

Instituti për Hulumtimin e Sundimit të Ligjit dhe për të Drejtat e Njeriut (IHSLDNJ) është themeluar në vitin 2017 në kuadër të Universitetit Haxhi Zeka në Pejë. Sipas deklaratës së tij të misionit ³², IHSLDNJ është rrugë-zbulues hulumtues në rajon i cili përfshihet në mënyrë kritike në diskutet bashkëkohore për teorinë dhe jurisprudencën e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe për studime të paqes. Instituti fokusohet në fushat kyçe në vijim: analizimi i teorisë dhe praktikës së parimeve të sundimit të ligjit, eksplorimi kryqëzimit në mes diturisë për të drejtat e njeriut dhe praktikës, analizimi i dimensioneve të drejtësisë tranzicionale, dhe eksplorimi i strategjive për ndërtimin e paqes. Instituti duket se fokusohet në rolin edukativ dhe hulumtues që lidhet me të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe me drejtësinë tranzicionale.

Sa i përket ankorimit institucional të të drejtave të njeriut, një ide interesante ka ardhur nga respondentit nga Universiteti i Pejës që pohon se nevojitet të themelohet institucioni Universiteti i Avokatit të Popullit i cili do të merrej drejtpërsëdrejti me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të studentëve dhe të personelit. Kjo iniciativë në universitetet e reja do të mund të harmonizohej mirë me mekanizmin ekzistues të Qendrës për të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Prishtinës lidhur me promovimin, mbrojtjen dhe ndërtimin e kapaciteteve në fushën e të drejtave të njeriut.

³²Deklarata e misionit është vënë në dispozicion nga ana e të anketuarve nga Universiteti Haxhi Zeka në Pejë.

Proceset dhe iniciativat për të drejtat e njeriut në universitete

Siç u cek në titullin e këtij paragrafi, kjo pjesë trajton iniciativat që bien nën fushëveprimin e të drejtave të njeriut në kuadër të universiteteve. Të anketuarit nga universitetet raportuan iniciativa të ndryshme në këtë drejtim. Zakonisht, këto janë përpjekje individuale dhe josistematike që tregojnë aspekte të caktuara lidhur me qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut. Një i anketuar nga Universiteti i Mitrovicës e ilustron këtë si në vijim: *“Ekzistojnë shumë iniciativa të planifikuara dhe në vazhdim e sipër të cilat promovojnë dhe lehtësojnë të mësuarit dhe performancën e grupeve të ndryshme të cenueshme (gjinia, komuniteti, nevojat e veçanta). Për shembull, kompleksi i universitetit tonë lehtëson qasjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha ambientet e Universitetit. Ekzistojnë barriera të reja për personat me aftësi të kufizuara në kompleksin e ri të universitetit, ka platforma të posaçme për karrige lëvizëse, platforma për komoditete të fakultetit dhe rektoratit, tualete të posaçme, ashensor dhe vend parkime të rezervuara.”* Universitetet tjera raportojnë heqjen e tarifave studimore për studentët e privuar nga ana sociale dhe për ata që vijnë nga radhët e grupeve të cenueshme dhe nga komunitetet etnike (si komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian). Këto praktika janë zakonisht me karakter institucional me disa iniciativa individuale. Universiteti i Gjakovës i referohet Ligjit për Barazi Gjinore, Udhëzimeve Administrative dhe Statutit të UGFA si dokumente që aplikohen nga këto institucione në praktikat dhe proceset e tyre. Në të njëjtën kohë, i referohen pjesëmarrjes së studentëve në vendimmarrje duke deklaruar se *“Studentët përfaqësohen në të gjitha proceset e vendimmarrjes, përfshirë në Bordin Qeverisë, në Senat, në Komisionin Qendror për Sigurim të Cilësisë dhe në Këshillat e Fakultetit.”* Janë paraqitur edhe shembuj tjerë nga respondentët, por ata nuk janë përpjekje sistematike dhe nuk përbëjnë qasje të zhvilluar plotësisht të bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin e lartë.

Bashkëpunimi me partnerët tjerë jo-universitar të angazhuar në të drejtat e njeriut

Iniciativat për bashkëpunim me partnerë jo-universitar dhe OJQ i mundëson universiteteve jo vetëm t'i adresojnë të drejtat e njeriut të personelit dhe studentëve në universitete, por edhe ta japin kontributin e tyre në përmirësimin e gjendjes së të drejtave të njeriut në shoqëri. Shumica e respondentëve nga universitetet publike të përfshirë në studim raportuan disa aktivitete në fushën e të drejtave të njeriut me partnerë jo-universitar. Respondentët nga Universiteti i Mitrovicës raportuan se *“Institucioni ynë bashkëpunon me shumë OJQ dhe institucione tjera që promovojnë të drejtat e njeriut; kohëve të fundit, në fillim të dhjetorit 2019, kemi pasur një takim bashkëpunimi me OJQ “Njerëzit e Vegjël të Kosovës”; përveç kësaj, jemi anëtarë të Rrjetit Hulumtues LSEE për Kohezionin Social në Evropën Juglindore (SEE). Përmes hulumtimit, në këtë rrejt adresojmë çështjet e barazisë dhe ato gjinore, përfshirjen e romëve, etj.”*

Iniciativa të ngjashme u raportuan edhe nga universitete tjera, gjithashtu. Për ilustrim, Universiteti i Gjakovës raportoi disa aktivitete, si “Projekte bashkëpunimi si ai me Medica Kosova për përkrahjen e grupeve të cënueshme, me OJQ “Rrjeti Qeliza” në një projekt që synon fuqizimin e grave” me Rrjetin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Me Organizatën e Grave të Kosovës “RROGRAEK” kemi pasur disa sesione informative me pjesëmarrje aktive në temën “Dhuna me bazë gjinore”. Respondentët nga Universiteti i Prishtinës njoftuan për iniciativë të organizuara me organizata ndërkombëtare si “Community Building Mitrovica (CBM)”, “Youth Initiative for Human Rights (YIHR)”, “Humanitarian Law Centre - Kosovo”, “GIZ”, “UNDP”, etj. Në përfundim, vlen të ceket se përkundër përpjekjeve dhe iniciativave të vazhdueshme, numri i aktiviteteve akoma nuk është në nivelin e duhur për t’iu përgjigjur nevojave të shoqërisë dhe potencialit për bashkëpunim në mes universitetit dhe sektorit jo-universitar në fushën e të drejtave të njeriut. Kjo konfirmohet nga një respondent nga Universiteti i Prishtinës i cili mendon se: *“Ka disa iniciativë dhe projekte në vazhdim e sipër me subjekte jo-universitare, por për shkak të madhësisë së universitetit tonë (të Prishtinës), numrit të universiteteve publike në Kosovë dhe nevojave të universiteteve dhe të shoqërisë në fushën e të drejtave të njeriut, nevojitet të ketë përpjekje më sistematike dhe më shumë bashkëpunim.”*

Sa i përket prezencës apo mungesës së ndonjë programi për ndërtimin e kapaciteteve në fushën e të drejtave të njeriut në universitetet publike në Kosovë, shumica e respondentëve kanë përmendur mungesën e përpjekjeve të tilla në universitetet e tyre përkatëse. Përveç Qendrës për të Drejtat e Njeriut dhe Qendrës për Burime të Drejtësisë Tranzicionale të Universitetit të Prishtinës të cilat ofrojnë ngjarje të kufizuara trajnuese në fushën e të drejtave të njeriut, universitetet tjera nuk ofrojnë masa të ngjashme të ndërtimit të kapaciteteve. Mungesa e masave të tilla për ndërtimin e kapaciteteve është e dukshme në universitetet e reja. Opsioni më i mirë, të paktën në afat të shkurtë, mund të jetë që dy Qendrat e Universitetit të Prishtinës të shërbejnë si burime trajnimi që furnizojnë të gjitha universitetet tjera në fushat përkatëse të të drejtave të njeriut.

Si përfundim nga anketa e shkurtë me menaxhmentin dhe personelin e universiteteve publike, mund të thuhet se: (i) ekziston pikëpamje e izoluar për qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut që i referohet vetëm çështjeve gjinore apo si bursa për komunitetet pakicë dhe grupet e cënueshme; (ii) ekzistojnë disa iniciativë, si brenda universiteteve ashtu edhe me hisedarët tjerë jo-universitarë por ato nuk arrijnë të jenë përpjekje sistematike dhe as qasje e zhvilluar plotësisht për të drejtat e njeriut; (iii) Qendrat për të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin e Pejës kanë dukshëm më shumë potencial dhe rol më të madh për ndërtimin e kapaciteteve dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Universitet dhe jo vetëm; dhe (iv) zgjidhje tjera kreative duhet të merren në konsideratë (si Universiteti i Avokatit të Popullit) për të avancuar zbatimin e të drejtave të njeriut në universitete dhe në shoqërinë kosovare.

V. Konkluzionet dhe rekomandimet

Konkluzionet

Ky rishikim është fokusuar në përfshirjen e qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në kornizën ligjore dhe në politikat e arsimit të lartë në Kosovë dhe në zbatimin e saj nga institucionet e arsimit të lartë. Shumica e konkluzioneve janë paraqitur në pjesët e analizave kritike në pjesën e rezultateve. Rezultatet e rishikimit kanë dëshmuar se Kushtetuta e Republikës së Kosovës është dokumenti më i avancuar në këtë drejtim, që ofron një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut që i përshtaten sektorit të arsimit në përgjithësi, dhe arsimit të lartë në veçanti. Duke iu referuar objektivave kryesore dhe metodologjisë së këtij rishikimi, dhe duke i përdorë dispozitat e Kushtetutës së Kosovës si një pikë referimi, mund të konstatohet se ajo i adreson çështjet e të drejtave të njeriut në aspektin e **përmbajtjes, si dhe ofron zgjidhje të barabarta/jo-diskriminuese dhe ka për qëllim t'i adresojë situatat individuale të grupeve të synuara**. Në tabelën e mëposhtme është përshkruar mënyra se si dokumentet e ndryshme ligjore dhe politikat në Kosovë i adresojnë të drejtat e njeriut: a i adresojnë aspektet specifike të drejtave të njeriut në përmbajtje (të drejtat e njeriut si përmbajtje); a ofrojnë dispozita të barabarta ligjore për grupe të ndryshme të synuara; apo a parashohin masa aktive (veprim afirmativ) për ta arritur paanshmërinë - duke i adresuar nevojat specifike të individëve ose grupeve të caktuara.

Korniza ligjore	Prania dhe natyra e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut		
	Përmbajtja	Barazia	Paanshmëria
Kushtetuta e Republikës së Kosovës	X	X	X
Ligji mbi Arsimin e Lartë	X	X – një masë për të gjithë	-
Udhëzimet Administrative	X	X – pjesërisht	-
Plani Strategjik i Arsimit (PSAK)	X	X	- Nuk ka për AL
Planet strategjike të universiteteve	-	X	-
Universiteti / statutet institucionale	X – nuk janë të bashkëngjitura	X- pjesërisht	-
Manuali i akreditimit	X	X	X

Në anën tjetër, përjashtoj Kushtetutën e Kosovës, korniza ligjore që e rregullon arsimin e lartë të Kosovës e aplikon një qasje të kufizuar dhe të fragmentuar në çështjet e të drejtave të njeriut, prandaj edhe i mungon një qasje e qëndrueshme dhe sistematike e bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin e lartë. Zakonisht, dokumentet dhe rregulloret nuk i referohen në mënyrë specifike të drejtave të njeriut ose Dimensionit Social të Arsimit të Lartë (përveç rregulloreve që adresojnë drejtpërdrejt lirimimin nga pagesa të studentëve për kategorinë e studentëve të cenuar në aspektin social).

Në të njëjtën kohë, rregulloret dhe procedurat institucionale të shtatë universiteteve publike i trajtojnë edhe më pak sistematikisht të drejtat e njeriut dhe Dimensionin Social. Kryesisht, këto rregullore e trajtojnë Dimensionin Social në kuadër të rregulloreve që i heqin pagesat për studentët dhe ofrojnë bursa për kategori të ndryshme të studentëve (siç janë studentët e prekur nga lufta e fundit), por zakonisht kanë dështuar ta aplikojnë një qasje sistematike të të drejtave të njeriut (sa i përket gjinisë, komunitetit, grupeve të nën-përfaqësuar ose personave me nevoja të veçanta arsimore) ose në ofrimin e një mbështetje më të madhe për ta përmirësuar performancën e studentëve individual, pavarësisht prejardhjes dhe statusit të tyre social.

Rekomandimet

➤ Ligji mbi Arsimin e Lartë

Dispozitat ligjore të Ligjit aktual për Arsimin e Lartë nuk e përfshijnë një kornizë të duhur për nxjerrjen e akteve nënligjore që do t'i përcaktonin edhe më shumë mundësitë e barabarta në arsimin e lartë dhe një aplikim gjithëpërfshirës të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut. Siç u cek më lartë, LAL është në proces të rishkrimit dhe në procedurën parlamentare për t'u zëvendësuar me një ligj tjetër për arsimin e lartë. Sido që të jetë, sektori i arsimit të lartë duhet ta shfrytëzojë këtë mundësi që i është ofruar në frymën dhe dispozitat e kushtetutës që të ndërmerren një veprim afirmues, dhe masa pozitive që bazohen në nevojat specifike të individëve dhe grupeve.

- *Sa i përket Udhëzimeve Administrative të MASHT-it, mund të merren parasysh dy opsione:*
 - *Të zhvillohen politika për integrimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në çdo akt ligjor dhe nënligjor që do të zhvillohet dhe miratohet në të ardhmen, me pjesën e dispozitave kalimtare që përcaktojnë zbatimin e parimeve të njëjta në Udhëzimet dhe Rregulloret aktuale administrative, ose*
 - *Të hartojë një Udhëzim administrativ ku do të përcaktohet qasja e bazuar në të drejtat e njeriut për sa i përket zbatimit të ndonjë dispozite të akteve aktuale nënligjore që e rregullojnë arsimin e lartë.*

➤ Statutet e universitetit

Si rezultat i hulumtimit nga zyra, mund të supozohet se Universiteti i Prishtinës (duke përfshirë studentët dhe stafin) dhe universitetet rajonale do të mund ta përmirësonin portfolion e tyre të të drejtave të njeriut, por edhe performancën akademike me anë të një qasje të integruar që bazohet në të drejtat e njeriut në dispozitat e Statutit të Universitetit. Përmirësimi i informatave dhe transparencës, përshtatja e kushteve të testimit ndaj nevojave individuale të studentëve, parashikimi me kohë dhe i saktë i informatave kthyes nga vlerësimi i studentëve, ofrimi i mbështetjes gjuhësore dhe teknologjike për studentët, rregullimi i kushteve të infrastrukturës fizike, përcaktimi i dispozitave më të qarta lidhur me dorëzimin dhe trajtimin e ankesave të studentëve, dhe dispozita tjera të ngjashme, mund të ndihmojnë në përmirësimin e jo vetëm trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminues të grupeve të ndryshme të studentëve, por edhe performancën e tyre akademike, që janë në thelb të misionit të çdo universiteti.

➤ Udhëzimet e AKA

Duhet të bëhen përpjekje të veçanta për trajnimin e menaxhmentit të universiteteve, mësimdhënësve dhe stafit akademik në zbatimin e Udhëzimeve të Akreditimit të AKA-së dhe standardeve dhe treguesve të akreditimit. Universitetet duhet t'i rishikojnë rregulloret dhe procedurat e tyre, por edhe planet e tyre strategjike, për të siguruar zbatimin e plotë të standardeve dhe treguesve të tyre si mënyra për plotësimin e kritereve të akreditimit.

➤ Strategjitë kombëtare për arsim

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 duhet të rishikohet në mënyrë që të shtrihet qasja e të drejtave të njeriut e nivelit të arsimit para-universitar në nivelin e arsimit të lartë dhe në hulumtime shkencore. Ky rishikim duhet t'i marrë parasysh nevojat dhe natyrën specifike të arsimit të lartë dhe hulumtimit shkencor.

➤ Planet strategjike institucionale

Planet aktuale strategjike duhet të rishikohen për të mundësuar një qasje më koherente dhe sistematike të planifikimit (në vend të planifikimit të improvizuar dhe të masave ad-hoc) si dhe të përfshirjes së të drejtave të njeriut në mënyrë sistematike në institucionet e tyre. Planet strategjike duhet, po ashtu, t'i përshtatin objektivat dhe masat e tyre kundruall standardeve dhe treguesve të performancës në përputhje me Udhëzimet e Akreditimit të AKA-së.

➤ Rregulloret dhe procedurat institucionale

Për të pasur një qasje më efikase, dhe në vend që të rishikohen të gjitha rregulloret dhe procedurat, universitetet duhet të hartojnë dhe miratojnë një ose më shumë rregullore që do të sigurojnë integrim sistematik të të drejtave të njeriut në të gjitha funksionet dhe veprimet e universiteteve. Një rregullore e tillë do të mund të përfshinte parimet e të drejtave të njeriut në institucionet e tyre, grupet e studentëve që duhet mbështetur, aktivitetet kryesore mbështetëse, kuotat përkatëse (kurdo që të zbatohet), etj. Këto pastaj do të mund të aplikoheshin edhe gjatë zbatimit të dispozitave të rregulloreve dhe procedurave të kaluara dhe atyre të ardhshme. Është me rëndësi që këto rregullore të monitorohen në mënyrë të përpiktë gjatë zbatimit të tyre deri sa rutina e duhur e punës dhe *habitus*³³ (Swartz, 2002) të instalohen në mënyrë të qëndrueshme në institucione.

Universitetet duhet ta shqyrtojnë mundësinë e themelimit të institucionit të Ombudspersonit të Universitetit me përgjegjësi dhe autorizime të përcaktuara qartë.

➤ Ngritja e kapaciteteve

Për këtë qëllim, universitetet duhet ta zhvillojnë një program, për she mbull, Programin e Edukimit për të Drejtat e Njeriut³⁴ ose një program hyrës për stafin e universitetit me objektiv të përgjithshëm për të siguruar zbatimin efektiv të standardeve të të drejtave të njeriut në universitet dhe për të ofruar mjete dhe metodologji të mësimdhënies, hulumtimit dhe aftësimit në fushën e të drejtave të njeriut. Ky program trajnimi duhet të fokusohet gjithashtu në krijimin e rutinës ndërmjet stafit dhe studentëve të cilët i promovojnë dhe i zbatojnë të drejtat e njeriut jo vetëm në universitete por edhe më gjerë.

Menaxhmenti i universitetit duhet, po ashtu, t'i ofrojë stafit menaxhues, stafit akademik dhe studentëve njohuri për të drejtat e njeriut në fushat e tyre përkatëse. Për ta ilustruar këtë rekomandim, Fakulteti për Administrim të Biznesit do të duhej të jetë i njoftuar me rolin e ndërmarrjeve të biznesit si organe të specializuara të shoqërisë që kryejnë funksione të specializuara, dhe me obligimin e tyre që t'i respektojnë të gjitha ligjet në fuqi dhe të drejtat e njeriut. Në të njëjtën kohë, në kurrikulat e biznesit, studentët duhet të aftësohen në atë mënyrë që ndërmarrjet e tyre të ardhshme të biznesit të dinë se si t'i respektojnë të drejtat e njeriut gjatë aktiviteteve të tyre.

³³ Një term i shpikur nga sociologu francez Pierre Bourdieu që nënkupton shprehitë dhe mendësinë që krijohet përgjatë përvojës individuale në një komunitet të caktuar.

³⁴ Ky paragraf është përshtatur nga ideja e një të anketuari nga Universiteti I Pejës.

➤ Qendra për të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Prishtinës

Me përvojën dhe ekspertizën që e ka krijuar që nga themelimi i saj në vitin 2002, Qendra për të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Prishtinës mund të shërbejë si një qendër burimore për të gjitha institucionet tjera të arsimit të lartë, të paktën për një periudhë afat-shkurtër, deri sa universitetet tjera t'i kenë zhvilluar kapacitetet e tyre institucionale dhe njerëzore në këtë drejtim. Kjo qendër mund të zhvillojë trajnime dhe t'i koordinojë aktivitetet në universitetet tjera dhe IAL me qëllim të përmirësimit të portfolios dhe praktikave të drejtave të njeriut në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. Kjo qendër do të mund të përdorte ekspertizën e konsiderueshme që aktualisht e ka në dispozicion jo vetëm në Universitetin e Prishtinës në fushën e të drejtave të njeriut.

➤ Instituti për Hulumtim të Sundimit të Ligjit dhe të Drejtave të Njeriut (IHSLDNJ)

Përderisa Qendra për të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Prishtinës duket se fokusohet kryesisht në të drejtat e njeriut dhe aspektet praktike të promovimit dhe aplikimit të të drejtave të njeriut në UP, IHSLDNJ si një institucion ndërdisiplinor fokusohet më shumë në hulumtime dhe aktivitete arsimore në fushën e sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë sociale. Në bazë të kësaj, pritet që IHSLDNJ të fokusohet edhe më tej në hulumtime dhe zhvillim të kurrikulave për të drejtat e njeriut nga perspektiva ndërdisiplinore. Në këtë drejtim, këto dy institucione mund të punojnë bashkërisht në mënyrë komplementare, duke e zgjeruar përgjithësisht portfolion e të drejtave të njeriut në sistemin dh e institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.

➤ Donatorët dhe partnerët zhvillimor:

Universitetet publike dhe institucionet tjera të arsimit të lartë u gjenden në një situatë të re kur u miratuan Udhëzimet e Akreditimit të AKA-së në vitin 2018. Duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë të këtyre Udhëzimeve për të fituar apo humbur akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, partnerët ndërkombëtarë, por edhe autoritetet vendore dhe OJQ-të mund ta luajnë një rol të rëndësishëm nëse i mbështesin universitetet në përmirësimin e strukturës së tyre institucionale dhe rregullatorë për t'i përmbushur më mirë këto kërkesa. E njëjta vlen edhe për fushën e të drejtave të njeriut që zë një vend të rëndësishëm në këto Udhëzime. HERAS do të mund të ishte në një pozitë të veçantë që ta shfrytëzojë ekspertizën dhe përvojën që është në dispozicion për t'i mbështetur universitetet në përmbushjen e udhëzimet përkatëse në kuadër të drejtave të njeriut.

Referencat

- EHEA. (2007). *2007 London Communiqué - Towards the European Higher Education Area: responding to challenges of a globalised world*. London: EHEA.
- Qeveria e Republikës së Kosovës. (2008). *Ligji mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë*. Prishtinë: QeK, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
- HigherKos. (2015). *RAPORT: Përmbledhje nga diskutimet e fokus grupeve lidhur me zbatimin e dimensionit social të Bolonjës në Kosovë*. Prishtinë: HigherKos.
- Agjencia e Akreditimit të Kosovës. (2018). *Manuali i Akreditimit*. Prishtinë: AKA.
- Loxha, B. (2018). *Aplikimi i të Drejtave të Njeriut në kurrikulat e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"*. Prishtinë: HERAS.
- MASHT. (2011). *Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës*. Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nxjerrë nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2761>
- MASHT. (2017). *Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021*. Prishtinë: MASHT.
- Ministria e Punëve të Brendshme. (2013). *Strategjia për Reintegrimit të Personave të Riatdhesuar*. Prishtinë: MPB.
- Zyra e Krye-Ministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë. (2017). *Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021*. Prishtinë: ZKM. Nxjerrë nga http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/ANG-STRATEGJIA_P%C3%8BR_P%C3%8BRFSHIRJEN_E_KOMUNITETEVE_ROM_DHE_ASHKALI_N%C3%8B_SHOQ%C3%8BRIN%C3%8B_KOSOVARE_2017-2021.pdf
- Rexhaj, X. (2018). *Funksionimi i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës* (Vols. Series: Public Interest, Volume 14). Pristina: D4D Democracy for Development.
- Swartz, D. L. (2002). The Sociology of Habit: The Perspective of Pierre Bourdieu. *The Occupational Therapy Journal of Research*, 22 - Supplement(Winter Issue), 61S-69S.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008). *Ligji mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë - Ligji Nr. 03/L-047*. Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008). *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
- The Council of Europe. (1950). *The European Convention on Human Rights*. Rome, Strasbourg: The Council of Europe. Retrieved from https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf
- UNICEF. (2007). *A Human Rights-Based Approach to Education for All*. New York: UNICEF.
- Unicef Finland. (2015). *Introduction to Human Rights Based Approach*. Helsinki: The Ministry of Foreign Affairs of Finland.

Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan. (2017). *Strategjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit 2017-2022*. Gjilan: Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan.

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren. (2018). *Plani strategjik 2018-2020*. Prizren: UUHP.

Universiteti i Gjakoves "Fehmi Agani". (2015). *Plani Strategjik i Universitetit 2015-2020*. Gjakova: Universiteti i Gjakoves.

Universiteti i Mitrovices "Isa Boletini". (2018). *Plani Strategjik 2018-2021*. Mitrovica: UMIB.

Universiteti i Prishtines "Hasan Prishtina". (2017). *Plani strategjik i Universitetit te Prishtines "Hasan Prishtina" 2017-2022*. Prishtina: UPHP.

Aneksi 1: Lista e dokumenteve të rishikuara

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Ligji mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës

20 udhëzime administrative të MASHT-it që rregullojnë arsimin e lartë

Statuti i Universitetit të Prishtinës

Statuti i Universitetit të Prizrenit

Statuti i Universitetit të Pejës

Statuti i Universitetit të Mitrovicës

Statuti i Universitetit të Shkencave të Aplikuara, Ferizaj

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021

Strategjia Kombëtare për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë e Kosovës

Strategjia Kombëtare për Re-integrimin e Personave të Riatdhesuar

Planet Strategjike të pesë universiteteve publike: Universitetit të Prishtinës, Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë, Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan dhe Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

Manuali i akreditimit i Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Aneksi 2: Ekstrakt i nxjerrë nga Manuali i Akreditimit që përmban dispozitat përkatëse të QBDNj (standardet dhe treguesit)

Kjo është një pasqyrë e standardeve më të rëndësishme (jo të gjitha) dhe treguesve të performancës së Manualit të Akreditimit të AKA-së që përfshijnë qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut në IAL-të, si për strukturën institucionale ashtu edhe për programet e studimit. Vetëm dy seksione janë përfshirë më poshtë të cilat rregullojnë në mënyrë më specifike fushën e studentëve dhe të shërbimeve studentore. Megjithatë, ekzistojnë edhe dispozitat individuale në seksionet tjera që mund të shërbejnë për ndërtimin e një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë (siç është Treguesi i fundit i Performancës në fushën 5. Menaxhmenti, në fund të këtij ekstrakti).

9. Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse:

Standardi 9.1. Kërkesat e pranimit janë të specifikuar qartë dhe janë të përshtatshme për institucionin dhe programet e tij; kërkesat e pranimit aplikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtë.

Standardi 9.2. Informata të plota për institucionin, duke përfshirë programet dhe kurset, kërkesat e programit, shërbimet, mundësitë për bursa, pagesat për shkollim dhe taksat administrative dhe informatat tjera relevante, do të vihen në dispozicion publik para aplikimit për pranim.

Standardi 9.3. Është organizuar një program gjithëpërfshirës orientimi për studentët fillestarë për të siguruar që ata kanë njohuri të plotë lidhur me të gjitha shërbimet dhe lehtësitë që janë në dispozicion të tyre, politikat dhe procedurat e institucionit dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.

Standardi 9.4. Një sërë bursa dhe mbështetje financiare janë në dispozicion të studentëve me qëllim që të stimulohet dhe shpërblehet performanca, si dhe të mbështeten financiarisht studentët me gjendje të pavolitshme sociale. Këto dy kategori dhe kriteret e tyre funksionojnë ndaras; këto bursa dhe mbështetja financiare mund të akumulohen.

Standardi 9.5. Ekzistojnë procese efektive për t'i mbledhur dhe analizuar të dhënat e besueshme që kanë të bëjnë me profilin e popullatës studentore, progresin e studentëve, suksesin dhe shkallën e braktisjes së studimeve, kënaqshmërinë e studentëve me programet e tyre, burimet e të nxëniet dhe mbështetjen e studentëve që është në dispozicion, dhe rrugëtimin e të diplomuarve në karrierë. Të dhënat statistikore përdoren për qëllime të sigurimit të cilësisë, si dhe për ta mbështetur vendimmarrjen.

Standardi 9.6. Manuali për studentë është në dispozicion të gjithë studentëve në kuadër të institucionit, dhe i përfshinë të gjitha informatat që kërkohen për të gjitha fazat e "ciklit të jetës" së një studenti - pranimin, përparimin, njohjen dhe certifikimin – duke përfshirë të gjitha rregulloret përkatëse, të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve, veprimet që duhen ndërmarrë lidhur me shkeljet disiplinore, përgjegjësitë e nëpunësve dhe komisioneve përkatëse, si dhe ndëshkimet që mund të vendosen.

Standardi 9.7. Procedurat e ankimimit të studentëve janë të përcaktuara në rregullore, të publikuara dhe janë të njohura gjerësisht brenda institucionit. Rregulloret e përcaktojnë qartë bazat mbi të cilat mund të bëhen ankimimet akademike, kriteret për vendimet dhe mjetet juridike në dispozicion. Procedurat e ankimimit garantojnë shqyrtim të paanshëm nga personat apo komisionet pavarësisht palëve të përfshira.

Standardi 9.8. Politikat dhe procedurat e duhura janë të përcaktuara për t'i trajtuar sjelljet e pahijshme akademike, duke përfshirë plagjiaturën dhe forma të tjera të mashtrimit.

Standardi 9.9. Gama e shërbimeve të ofruara dhe burimet që u dedikohen studentëve i reflektojnë të gjitha kërkesat e popullatës studentore. Janë hartuar plane formale për ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve të studentëve; zbatimin dhe efektivitetin e këtyre planeve monitorohet në baza të rregullta.

Standardi 9.10. Efikasiteti dhe rëndësia e shërbimeve studentore monitorohet rregullisht nëpërmjet proceseve që përfshijnë sondazhet e kënaqshmërisë. Shërbimet ndryshohen varësisht nga vlerësimi dhe informatat kthyesë të këtyre sondazheve.

Standardi 9.11. Këshillimi akademik, planifikimi i karrierës dhe këshillat për punësim, si dhe shërbimet e këshillimit personal ose psikologjik ofrohen pa pengesa për të gjithë studentët e institucionit.

Standardi 9.12. Mundësitë e studentëve për aktivitete jashtë-kurrikulare ofrohen nëpërmjet lehtësirave të përshtatshme dhe aranzhimeve organizative. Po ashtu, janë përcaktuar aranzhimet për organizimin dhe nxitjen e studentëve për të marrë pjesë në aktivitete jashtë-kurrikulare.

Treguesi i performancës 9.1. Këshilltarët që i njohin detajet e kërkesave të kurseve janë në dispozicion për të ofruar ndihmë para dhe gjatë procesit të pranimit të studentëve.

Treguesi i performancës 9.2. Janë krijuar dhe mirëmbahen rregullat e qarta lidhur me privatësinë e informatave dhe kontrollimin e qasjes në të dhënat individuale të studentëve.

Treguesi i performancës 9.3. Rregullat që përcaktojnë pranimin me kredi për studimet e mëparshme janë të specifikuara qartë; vendimet për kreditë për studimet e mëparshme u komunikohen studentëve nga stafi i kualifikuar përpara fillimit të ligjëratave.

Treguesi i performancës 9.4. Janë përcaktuar procedurat e automatizuara për monitorimin e progresit të studentëve përgjatë programeve të tyre; afatet kohore për raportimin dhe regjistrimin e rezultateve dhe azhurnimin e të dhënave janë të përcaktuara qartë dhe ato aplikohen.

Treguesi i performancës 9.5. Një anëtar i lartë i stafit është i ngarkuar me përgjegjësinë për t'i mbikëqyrur dhe zhvilluar shërbimet mbështetëse për studentët.

Treguesi i performancës 9.6. Shërbimet mjekësore për studentët janë të qasshme dhe ato drejtohen nga personeli me kualifikime përkatëse.

5. Studentët:

Standardi 5.1. Ekziston një procedurë e qartë dhe e pranuar zyrtarisht në nivel institucional që një program i studimit duhet ta respektojë kur e organizon rekrutimin e studentëve. Kërkesat për praninë aplikohen në mënyrë konsistente dhe të drejtë për të gjithë studentët.

Standardi 5.2. Të gjithë studentët e regjistruar në programin e studimeve kanë diplomë të kryerjes së shkollës së mesme ose një dokument tjetër ekuivalent shkollimi, në përputhje me kërkesat e MASHT-it.

Standardi 5.3. Grupet e studimit janë të dimensionuara për të siguruar një proces efektiv dhe interaktiv të mësimdhënies dhe nxënies.

Standardi 5.4. Informatat kthyesë për studentët lidhur me performancën e tyre dhe rezultatet e vlerësimit të tyre jepen me kohë dhe shoqërohen me mekanizma të mbështetjes nëse është e nevojshme.

Standardi 5.5. Rezultatet e fituara nga studentët gjatë gjithë cikleve të studimit janë të certifikuara me të dhënat akademike.

Standardi 5.6. Trajtimi fleksibël i studentëve në rrethana të veçanta është siguruar për sa i përket afateve dhe kërkesave formale në program dhe në të gjitha provime t.

Standardi 5.7. Të dhënat lidhur me notat e përfundimit të të gjitha kurseve dhe programit në tërësi nga studentët mbahen dhe përfshihen në kuadër të treguesve të cilësisë.

Standardi 5.8. Procedurat efektive përdoren për të siguruar që puna të cilën e do rëzojnë studentët është origjinale.

Standardi 5.9. Të drejtat dhe obligimet e studentëve bëhen publike, dhe promovohen në mesin e të gjithë atyre që janë të përfshirë si dhe aplikohen në mënyrë të barabartë; këtu përfshihet edhe e drejta për ankimime akademike.

Standardi 5.10. Transferimi i studentëve ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, fakulteteve dhe programeve të studimit është i rregulluar në mënyrë të qartë në dokumentet e brendshme formale të institucionit.

Standardi 5.11. Stafi akademik është në dispozicion në masë të mjaftueshme për konsultime dhe këshillim të studentëve. Ndhima adekuate në aspektin e udhëzimeve ofrohet për të siguruar që të nxëniet është kuptuar si dhe aftësinë për ta aplikuar nxënien.

Treguesi i performancës 5.1. Nëse është e nevojshme, do të përcaktohet një proces adekuat i përzgjedhjes dhe rregulla të njohjes për kualifikimet e huaja në pajtim me Konventën e Njohjeve të Lisbonës, si dhe për kualifikimet e fituara jashtë institucioneve të arsimit të lartë.

Treguesi i performancës 5.2. Janë krijuar sisteme për monitorimin dhe koordinimin e ngarkesës së punës të studentëve nëpër kurse. Ekzistojnë sisteme për monitorimin e progresit të studentëve individual me ndihmë dhe/ose këshillim që u ofrohet atyre që hasin në vështirësi. Shkalla e përparimit të studentëve dhe e përfundimit të programeve monitorohet dhe analizohet për çdo vit për t'i identifikuar dhe për të ofruar ndihmë për çdo kategori të studentëve që mund të kenë vështirësi.

Treguesi i performancës 5.3. Vlerësimi i testeve, detyrave dhe projekteve të studentëve bëhet me ndihmën e matricave ose mjeteve tjera për të siguruar që gama e planifikuar e fushave të rezultateve të të nxëniet të studentëve janë adresuar. Janë marrë masa në kuadër të institucionit për aftësimin e stafit mësimdhënës në teorinë dhe praktikën e vlerësimit të studentëve.

Treguesi i performancës 5.4. Ofrohen shërbimet mbështetëse (p.sh. në lidhje me programin e studimit, këshillimin e studentëve në rast të problemeve emocionale, financiare ose familjare, këshillimi në karrierë, çështje ndërkombëtare, këshilla juridike, etj.) si dhe ofrohen udhëzime lidhur me çështjet e lëndëve dhe ato ndërdisiplinore.

Treguesi i performancës 5.5. Tekstet mësimore dhe materialet referuese janë të përditësuara dhe përfshijnë zhvillimet e fundit në fushën e studimit. Tekstet mësimore dhe materialet tjera që kërkohen janë në dispozicion në sasi të mjaftueshme para fillimit të ligjëratave.

Treguesi i performancës 5.6. Fushat akademike ose profesionale për të cilat përgatiten studentët monitorohen vazhdimisht, ndërsa programi, tekstet mësimore dhe materialet referuese përshtaten sipas nevojës për të siguruar relevancën dhe cilësinë e vazhdueshme.

2. Menaxhmenti:

Treguesi i performancës 1.5. Koncepti i drejtësisë gjinore dhe promovimi i mundësive të barabarta për studentët në situata të veçanta siç janë, për shembull, studentët me probleme shëndetësore, studentët me fëmijë, studentët e huaj, studentët nga familjet e imigrantë, dhe/ose studentët nga familjet e pashkolluara aplikohet në nivel të programit të studimit.

Aneksi 3: Anketa me stafin dhe menaxhmentin e universiteteve publike

Çfarë e karakterizon qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut?

- Thekson **proceset** dhe **rezultatet**
- Tërheq vëmendjen ndaj **grupeve të marginalizuara**
- Punon në drejtim të **ofrimit të barabartë të shërbimeve**
- Zgjeron dhe e **thellon pjesëmarrjen**
- **Siguron pronësinë e vendorëve** ndaj proceseve të zhvillimit
- **Fuqizon llogaridhënien** e të gjithë akterëve

Aplikimi i QBDNj në institucionit tuaj në:

Mësimdhënia:

A është mësimdhënia e organizuar në atë mënyrë që t'i merr parasysh nevojat e të gjithë studentëve?

A është mësimdhënia e ndjeshme ndaj aspekteve të drejtave të njeriut - siç është barazia – equity, barazia gjinore, etj?

Kurrikulat

A trajtohen të drejtat e njeriut në kurrikulë?

A ekziston ndonjë kurs që i trajton të drejtat e njeriut në mënyrë specifike?

A janë zhvilluar kurrikulat në atë mënyrë që të jenë gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore dhe atyre të barazisë?

Materialet mësimore

A ka materiale mësimore për të drejtat e njeriut që përdorën në kurset ekzistuese?

A ka materiale mësimore?

A ekziston ndonjë kurs themelor për të drejtat e njeriut në universitetin tuaj?

Integrimi institucional i të drejtave të njeriut në IAL

A janë të përfshira të drejtat e njeriut dhe qasja e bazuar në të drejtat e njeriut në planin strategjik të institucionit tuaj?

A janë zbatuar masat dhe aktivitetet përkatëse?

A është marrë parasysh qasja e bazuar në të drejtat e njeriut në politikat, procedurat dhe proceset e menaxhimit (siç janë pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrje, përfaqësimi i barabartë gjinor, pjesëmarrja dhe përfaqësimi i grupeve të marginalizuara dhe grupeve etnike, etj.)?

Ekziston ndonjë mekanizëm/njësi/departament që merret drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë me të drejtat e njeriut?

Bashkëpunimi me partnerët tjerë lidhur me të drejtat e njeriut

A është duke u zhvilluar ndonjë bashkëpunim me institucionet tjera publike ose me OJQ -të në fushën e QBDNj në institucionin tuaj?

Praktikat

A udhëhiqen praktikat nga përpjekjet institucionale dhe të sistemit apo ato janë kryesisht iniciativa individuale?

A ofrohet mbështetje institucionale për ndonjë iniciativë individuale?

Ngritja e kapaciteteve

A është duke u realizuar ndonjë iniciativë apo projekt që e promovon qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut (duke përfshirë konceptet, praktikat, etj.)?

Mohimi i përgjegjesisë:

Ky dokument është hartuar me mbështetjen e ekspertëve të HERAS, dhe në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Projekti HERAS mbështetet financiarisht nga Agjencia Austriake për Zhvillim, me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe bashkëfinancim nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe realizohet nga një konsorcium, që përbëhet nga World University Service Austria (WUS AT, Lead), Qendra për Inovacion Social (ZSI) dhe Agjencia Austriake për Mobilitet dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Arsim, Shkencë dhe Hulumtime (OeAD). Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë dokument, nuk e pasqyrojnë në asnjë mënyrë opinionin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim, e as opinionin e partnerëve implementues.

KONSORCIUMI IMPLEMENTUES



